

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7650 E enjte 13 Shtator 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Kur arkeologu italian Ugolini zbuloi gjatë gërmimeve në Butrint kokën e Deas..., as mund të imagjinonte se pas pothuaj një shekulli, atje në ...

Vijon në faqet 20-21

Nga PËRPARIM KABO

Dea flet me gjuhën e imazhit....



Opinion i Ditës

Ardhja ime në këtë ceremoni nuk ka lidhje fare me Lulzim Bashën dhe as me partinë personale të tij. Unë kam ardhur sot të respektoj në radhë ...

Vijon në faqen 21

Nga ASTRIT PATOZI

PD është sot më keq se para 20 vjetësh



Arrestohen Valter Bami e Lutfi Haka

RENEA mësyn tek "të fortët e Niklës", 5 në pranga, kapen armë dhe municione

Operacioni "Forca e Ligjit, policia bën "raprezalje" në orët e para të mëngjesit

Fshati Nikël i Krutës, ku prej vitesh kanë bërë ligjin të "fortët" është zgjuar mëngjesin e djeshëm në shtetrrrethim policor. Policia e Shtetit ka zhvilluar një superoperacion të befashëm në fshatin e të ashtuquajturit "grup i Niklës", i përfshirë në një seri ngjarjesh kriminale në harkun kohor të 20 viteve. Operacioni, i cili drejtohej nga kreu ...

Në faqen 7

TRASHEGIMTARET DUHET TE PLOTESOJNE DOKUMENTET NE DREJTORINE E PAGESAVE

ISH-TE PERNDJEKURIT, EMRAT E 250 PERFITUESVE

Dëmshtëpërlimi financiar, kush merr paratë e këstit të dytë. 3 muaj afat për plotësimin e dosjes. Si vepohet kur llogaria bankare nuk është aktive



(Në foto) Ish-të përndjekur politikë

KUVENDI I KOSOVES

Veseli takon Metën, Ruçin dhe Bashën: Konsensus për dialogun me Serbinë

Në faqen 4

NGA YLLI POLOVINA

'14 shtatori', motra e Nanos telefoni në ambasadë: Si është im vëlla?

Në faqet 10-11

RREFIMI

61-vjeçari: Nuk e kam përdhunuar vajzën time, më rrahën të pranoja

Në faqen 5

ÇELET EKSPOZITA

Greg Rama, "traktat" për artin: Kush e shëmton të bukurën është i korruptuar

Suplement

"4 HERE ME SHUME SE VJET"



Raundi i parë i regjistrimeve, "Luarasi" tejkalon pritshmëritë

Në faqen 9

Homazhet/ 20-vjetori i vrasjes së Azem Hajdarit bën bashkë demokratët

Besnik Mustafaj: PD nuk është aty ku duhet

Kreu i PD: Do pastrojme politikën nga krimi. Meta: Demokracia do guxim

NGA VALENTINA MADANI

Në 20-vjetorin e vrasjes së liderit të dhjetorit Azem Hajdari, kreu i opozitës, Lulzim Basha u premtoi shqiptarëve se do të pastroj politikën nga krimi. Sipas Bashës, pushteti i lidhur me krimin është pengesa



për ëndrrën e Azemit për Shqipërinë si gjithë Evropa. "Zotohemi se do të pastrojme politikën nga krimi. Të shprehim vendosmërinë tonë, në ndër të të gjithë shqiptarëve dhe Azemit, se nuk do i nënshtrohemi së keqes, të zotohemi para Azemit se do ...

Në faqen 3

LIGJI I RI DEBATI

Pas përgjigjes së BE, Shalsi: Gati të ndërhyjmë në ligjin për Teatrin e ri

Mazhoranca hap garën për Teatrin, PD: KE e vërtetoi klientelizmin

Vokshi: Kundër çdo ligji që prek pronën publike

Valentina Madani

Dekrete të presidentit për Teatrin pritet të kalojnë në Kuvend më 20 shtator, ndërkohë që pas letrës së KE-së, mazhoranca ka hapur garën për ndërtimin e Teatrit të Ri, por pa hequr dorë nga shembja e godinës aktuale. Mazhoranca u shpreh se do të amendojë dekretin e Presidentit Meta, duke bërë të mundur që për ndërtimin e Teatrit të ketë një garë të hapur. Por për PD-në, kjo garë është vetëm fasadë, pasi në fund dihet kush do ta fitojë konkursin. Ndërkohë që pritet që dekreti i presidentit për Teatrin të kalojë në Kuvend dhe pak pasi BE dha përgjigjen për çështjen e Teatrit, duke theksuar se ligji nuk shkel MSA, por duhet garë e hapur, komisioni përgjegjës është i gatshëm të bëjë ndërhyrje në projektligji, duke hapur garën për subjektet e interesuara. Kryetari i Komisionit të Vepimitarisë Prodhuese, Eduard Shalsi, pranoi dje që mazhoranca u përfshi në zallamahinë e komenteve dhe nuk e trajtoi këtë çështje me seriozitetin e duhur që në fillim, prandaj ai bëri thirrje publike që gara është e hapur për këdo. "Po kristalizojmë idenë që ta përmirësojmë ligjin. Dekreti ka shumë pika për të cilën nuk biem dakord. Një pikë e cila ne mendojmë që ta përmirësojmë është që të mos jetë një subjekt, por të kemi një thirrje të hapur për cilindo subjekt të interesuar për ta zhvilluar si projekt. Ajo që ne po gjykojmë si një mundësi për ta përmirësuar ligjin është fakti që ne t'i japim mundësi çdo subjekti që ka një ide për të zhvilluar nga pikëpamja urbanistike të gjithë ato pjesë që është edhe TK, pra të mos pengojmë asnjë të interesuar të paraqesë një ide. Ajo që po bëjmë është se po reflektojmë dhe nëse ka një argument që duam ta marrim në konsideratë është



Deputetja e PD-së, Albana Vokshi

ALBANA VOKSHI

"Partia Demokratike është për rrëzimin e ligjit korruptiv e antikushtetues 'Rama-Fusha' dhe sigurisht miratimin e dekretit të presidentit", u shpreh këtë të mërkurë deputetja demokrate, Albana Vokshi. Sipas saj, deklaratat që vijnë nga kampi i mazhorancës për një hapje të garës për ligjin për Teatrin janë një farsë.



Demokratën dje në ceremoninë për Azem Hajdarin

EDUART SHALSI

"Ne jemi të gatshëm të përmirësojmë ligjin, thuhet që shkelet Konventa Ndërkombëtare e Trashëgimisë. Pika që do ndërhyjmë është që të mos jetë një subjekt, por të kemi thirrje të hapur për cilindo subjekt të interesuar për ta zhvilluar si projekt", - tha z.Shalsi.

LSI: Budallallëqet e Ramës për garën e hapur

"Teatri", Vasili: Po ndryshuan ligjin, të ndryshojnë edhe kryeministrin



aty është një tokë private, që kërkon ta shfrytëzojë. Aty është një sipërfaqe e pashfrytëzueshme, parking me makina të vjetra. Privati do të ndërtojë, ndërsa ne fitojmë Teatrin e ri. Çfarë gare do të bëh kur je

i kondicionuar nga fakti që do të përfshihet në këtë zhvillim prona që i zotëron dikush që ka emër dhe mbiemër", shprehet z.Vasili. Sipas tij: "Këto budallallëqe deklaroi ky kryeministri për garën e hapur. Po ndry-

Deklarata

"Këto budallallëqe deklaroi ky kryeministri për garën e hapur. Po ndryshuan ligjin këta të rilindjes, duhet të ndryshojnë edhe kryeministrin, që ia futi kot dhe gajasi dynjanë me shkollëpakësinë e vet. Edhe ndryshimi i ligjit, edhe kryeministri nuk rrinë dot".

shuan ligjin këta të rilindjes, duhet të ndryshojnë edhe kryeministrin, që ia futi kot dhe gajasi dynjanë me shkollëpakësinë e vet. Edhe ndryshimi i ligjit, edhe kryeministri nuk rrinë dot".



Opozita bojkoton sot Kuvendin, mblidhet në Durrës

Grupet parlamentare të Opozitës as sot nuk do të shkojnë në Kuvend gjatë seancës plenare. Opozita më herët kishte njoftuar që do të kishte një marrëdhënie të kushtëzuar me Kuvendin dhe bën me dije se do ta bojkotojë edhe këtë javë seancën plenare. "Grupet parlamentare të opozitës do ta zhvillojnë mbledhjen e grupit nesër (sot) në ora 10:00 në Durrës, tek hotel 'Adriatik'. Fjala hyrëse e kryetarit Basha do të jetë e hapur për mediat", shkruar në një njoftim nga zyra e shtypit të PD-së.

ky, që të mos kemi një subjekt, por të kemi disa subjekte për të marrë pjesë me një projekt për zhvillimin e zonës urbane", tha z.Shalsi. Shalsi u shpreh se javën tjetër komisioni do të bëjë gati amendimin e dekretit të Presidentit Meta, ku sipas tij, e vetmja pikë ku bien dakord është ftesa për garë të hapur. Por, parësisht kësaj, mazhoranca

pranon që propozuesi për ndërtimin e Teatrit të ri ka në zotërim një pjesë të trullit dhe deri më tani ka lidhur disa marrëveshje. Në kundërpërgjigje të mazhorancës ka reaguar edhe PD, e cila shprehet kundër çdo ligji që do të çojë në shembjen e Teatrit Kombëtar dhe tjetërsimin e pronës publike për llogari të pushtetit. Deputetja Albana

Vokshi e konsideroi hapjen e garës për ndërtimin e Teatrit të ri si një fasadë, pasi sipas demokrate, në fund të garës dihet fituesi. Vokshi përsëriti qëndrimin e demokrateve se PD është kundër çdo ligji që prish godinën e Teatrit Kombëtar dhe prek pronën publike. "PD është kundër çdo ligji që ka për subjekt shkatërrimin e Teatrit Ko-

mbëtar. PD është kundër çdo ligji që prek pronën publike, duke ia dhuruar privatit për interesa klienteliste. Kushtetua e ka të qartë ndarjen e pushtetit mes atij qendror dhe atij vendor. Rama në asnjë moment nuk ka nevojë për një ligj special. Edhe përgjigja e KE vërtetoi atë që tha PD, pra ligji 'Fusha' është klientelist.

PD e ka fare të qartë se ligji 'Rama-Fusha' është për pastrimin e parave. PD ka qenë që ditën e parë në krah të artistëve. U bëjmë thirrje qytetarëve që të mbrojmë me çdo kusht dhe kosto vlerat kulturore të Tiranës. Jemi krah artistëve dhe qytetarëve për mbrojtjen e Teatrit Kombëtar", deklaroi deputetja e PD-së.



Kush mungoi në ceremoninë për Azemin, Mustafaj letër imagjinare: Vendi po shkon keq!

Replika, Mustafaj: PD s'është aty ku duhet. Basha: Pushteti, i lidhur me krimin

Kreu i PD: Do pastrojmë politikën nga krimi

Valentina Madani

Në 20-vjetorin e vrasjes së liderit të dhjetorit Azem Hajdari, kreu i opozitës Lulzim Basha u premtoi shqiptarëve se do të pastrojë politikën nga krimi. Sipas Bashës, pushteti i lidhur me krimin është pengesa për ëndrrën e Azemit për Shqipërinë si gjithë Evropa. "Zotohemi se do të pastrojmë politikën nga krimi. Të shprehim vendosmërinë tonë, në ndër të gjithë shqiptarëve dhe Azemit, se nuk do i nënshtrohemi së keqes, të zotohemi para Azemit se do ta pastrojmë politikën nga krimi për t'i hapur vendit rrugën e bllokuar, se në vend do të ketë edhe liri dhe demokraci, ëndrra jote na udhëheq në betejën për fitoren e së mirës ndaj së keqes", tha Basha. Kreu i Partisë Demokratike Lulzim Basha mori dje pjesë në homazhet në nderim të themeluesit të PD-së dhe liderit të dhjetorit Azem Hajdari, në 20-vjetorin e vrasjes së tij. Z.Basha theksoi se "Azem Hajdari kujtohet në një 20-vjetor që na mori njeriun, por na dha legjendën e tribunit të heroit të demokracisë. E kujtojmë sot Azemin si njeri, si prind, si bashkëshort, shok, mik, qytetar, e respektuim si lider, simbol të kurajës për liri, dinjitet. Jeta e shkurtër por e plotë e tij duhet të na nxisë, Azem tregoi se para robërisë, dhunës, nuk duhet heshtur, por luftuar". Duke e lidhur me aktualitetin, Basha theksoi se "sot në mënyrë tragjike e epike na bën të reflektojmë për të keqen që i vjen shoqërisë dhe kombit kur bandat nënshtrojnë politikën e qytetarët. Pushteti i lidhur me krimin është pengesa për ëndrrën e Azemit për Shqipërinë si gjithë Evropën".



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dje në ceremoninë për Azem Hajdarin

LULZIM BASHA
"Sot në mënyrë tragjike e epike na bën të reflektojmë për të keqen që i vjen shoqërisë dhe kombit kur bandat nënshtrojnë politikën e qytetarët. Pushteti i lidhur me krimin është pengesa për ëndrrën e Azemit për Shqipërinë si gjithë Evropën. Ndaj zotohemi se do të pastrojmë politikën nga krimi", - tha z.Basha.

RUDINA HAJDARI

"Azem Hajdari ishte fare i ri kur nisi rrugëtimin e tij politik për të mposhtur komunizmin. Ai në 7 vjet realizoi ato që njerëzit e tjerë nuk do të mund t'i realizonin në shtatë jetë. Ëndrra e Azemit ishte Shqipëria si Evropa. Arsyeya pse Azem Hajdari e mposhti komunizmin, ishte se komunizmi nuk kishte respekt as për atdheun dhe as për familjen", - tha Rudina Hajdari.

BESNIK MUSTAFAJ
"PD nuk është aty ku historia e kërkon dhe ku do e donte Azemi për t'i dhënë zë politik kësaj pakënaqësie popullore duke mishëruar atë që është jetike sot, shpresën e njerëzve dhe për t'i udhëhequr këta njerëz drejt përmbushjes së ëndrrës tënde, për ta bërë Shqipërinë si të gjithë Evropa", - shprehet z.Mustafaj.



20-vjetori i vrasjes së Azemit, Meta: Demokracia kërkon guxim

Presidenti i Republikës, Ilir Meta në 20-vjetorin e vrasjes së Azem Hajdarit përcolli dje mesazhin se demokracia kërkon guxim. Figura e tij tha kreu i shtetit, na fton për të reflektuar dhe për të kuptuar se demokracia kërkon guxim.



ASTRIT PATOZI

"PD, 20 vite pas vrasjes së Azem Hajdarit është në periudhën e vet më të vështirë. Ne sot jemi më keq se përpara 20 vjetësh, jo thjesht në numra, por mbi të gjitha në frymë dhe në atë që po bën opozita dhe atë që përfaqëson sot PD e Lulzim Bashës", shprehet z.Patozi.

"Kjo figurë na fton për të reflektuar dhe për të kuptuar që demokracia nuk vjen si dhuratë dhe nuk qëndron si e tillë kërkon guxim për të fituar, por edhe për të mbrojtur çdo ditë, sepse tolerimi më i vogël i shkeljeve të të drejtave të njeriut, sot çon në një avancim të autoritarizmit edhe më të madh nesër. Populli ynë ka vuajtur shumë nga mungesa e demokracisë, është shumë e rëndësishme që kjo figurë shembulli i tij, frymëzimi i tij të gjenerojë një angazhim të madhe të të rinjve që kërkojnë më shumë mundësi dhe të luftojnë për më shumë demokraci. Ata e kanë më të lehtë se Azem Hajdari përpara 28 viteve. Azem Hajdari është një figurë e përmasave epokale që ka dhënë një mesazh të përgjeshëm për të gjithë shqiptarët, se demokracia kërkon guxim", deklaroi z.Meta.

"Donte të shkonte luftëtar në Kosovë"

Berisha: Azemi u vra nga shteti me uniformë, kishte armiq

Në 20-vjetorin e vrasjes së Azem Hajdarit, ish-kryeministri Sali Berisha vlerësoi figurën e tij si epokale. Gjatë fjalës së tij simpoziumin dhe Ekspozitën "Ëndrra e Azemit: Shqipëria si Evropa", Berisha akuzoi se atë e ekzekutoi shteti me uniforma. Po ashtu, Berisha u shpreh se Hajdari ishte një tribun i çështjes Kombëtare. Sipas Berishës, ai ka vuajtur shumë, sepse nuk shkonte dot luftëtar në Kosovë. "Ai ishte një lider epokal, aq sa ishte i zakonshëm ishte edhe i jashtëzakonshëm. Aq sa ishte i vrullshëm, aq dëgjonte dhe pranonte këshilla. Atë e vranë sigurisht, shteti me uniforma dhe natyrisht është jo reale të mendosh se ai nuk kishte armiq. Por nëse ka një njeri që ruante komunikimin me të tjerët, askush më shumë sesa ai. Ai kishte respekt për njeriun. Këtu qëndron arsyeja që ai ishte i gatshëm për të takuar dhe biseduar. Një tribun në çështjen kombëtare. Në takimin e parë me Besnik Mustafën, i them që ne jemi kosovarë dhe astu jemi. Tropoja është malësi Gjakovë dhe pa Shqipëri të lirë nuk ka Kosovë të lirë. Ky ishte problemi tek pluralizimi. Nuk besoj të ketë pasur njeri që të ketë vuajtur më shumë se ai se nuk po shkonte dot ai si luftëtar i thjeshtë në Kosovë. Një kërkesë që do t'ua paraqiste me insistim çdo ditë. Vendimi është vetëm i atij", theksoi z.Berisha.

gjithë Evropa ka ngecur. Korrupsioni është bërë një gangrenë që bren moralin e shoqërisë dhe po pengon zhvillimin e ekonomisë. Krimi i organizuar funksionon si federatë kartelesh duke e ndarë vendin në parcela për secilin kartel, sepse krimi i organizuar në fakt ka kapur shtetin. Shqiptarët i ka pushuar dëshpërimi. Gjeja e dytë që do i thosha është: PD nuk është aty ku historia e kërkon dhe ku do e donte Azemi për t'i dhënë zë politik kësaj pakënaqësie popullore duke mishëruar atë që është jetike sot, shpresën e njerëzve dhe për t'i udhëhequr këta njerëz drejt përmbushjes së ëndrrës tënde, për ta bërë Shqipërinë si të gjithë Evropa", -tha z.Mustafaj. Por nuk vonoi replika e kreut të PD-së Lul-

zim Basha në një tjetër aktivitet në nder të Azemit, tek memoriali i tij. "Pushteti i lidhur me krimin është pengesa për ëndrrën e Azemit Shqipëria si gjithë Evropa" tha z.Basha teksa i kthehe në mënyrë indirekte përgjigje Mustafajt. Homazhet për 20-vjetorin e vrasjes së Azem Hajdarit dje bënë bashkë disa nga figurat e rëndësishme të PD. Pas simpoziumit dhe ekspozitës "Ëndrra e Azemit: Shqipëria si Evropa" demokratët, presidenti Meta, përfaqësues të trupave diplomatike të akredituar në Tiranë familjarë dhe miq bënë homazhe pranë memorialit të Azemit. Në ceremoni mori pjesë ish-Presidenti, Bujar Nishani, ish-kryeministri, Sali Berisha, ish-ministri i Mbrojtjes, Arben Imami, ish-ministri Jashtëm, Besnik Mustafaj, etj. Gjatë ceremonisë ra në sy mungesa e ish-kryetares së parlamentit, Jozefina Topalli, e cila nuk ishte e pranishme në sallën e Hotel Plaza, ku u realizua simpoziumi dhe ekspozita, "Ëndrra e Azemit: Shqipëria si Evropa". Ndërkohë maxhoranca u përfaqësuar në këtë aktivitet nga ministri për Diasporën, Pandeli Majko. Në këtë aktivitet nuk morën pjesë as ish-nënkryetari i PD-së, Astrit Patozi dhe ish-ministri i Financave, Ridvan Bode. Këta të fundit morën pjesë vetëm në homazhet që u zhvilluan në Memorialin e ku u vra Azem Hajdari.

Liderët kosovarë konsulta me presidentin, kreun e Kuvendit dhe opozitën në Tiranë

Meta, Ruçi e Basha presin Veselin e Limajin: Konsensus për dialogun me Serbinë

Veseli: Kosova nuk do të marrë nga të tjerët, është shtet sovran

Darina Tanushi

Delegacioni nga Kosova, i kryesuar nga kreu i Kuvendit Kadri Veseli u prit dje, nga Presidenti Iliir Meta, kreu i Kuvendit, Gramoz Ruçi, kreu i opozitës Lulzim Basha, e ish-kryeministri Sali Berisha. Presidenti i Republikës, Iliir Meta u shpreh në takimin e zhvilluar se, "Kosova ka nevojë imediate për konsensus politik të brendshëm dhe gjithëpërfshirje në fazën përfundimtare të dialogut me Serbinë.

Situata kërkon që shumica qeverisëse të krijojë një klimë më gjithëpërfshirëse në raport me opozitën. Edhe opozita në Kosovë duhet të marrë përgjegjësitë e veta në këtë moment historik". Presidenti Meta tha se në këtë proces të rëndësishëm kërkohet bashkëpunim shumë më i ngushtë me partneret tanë strategjike të angazhuar për stabilitetin, sigurinë dhe të ardhmen europiane të rajonit. Në delegacionin kosovar bënin pjesë edhe zv/kryeministrat Fatmir Limaj dhe Dardan Gashi. Ndërkohë në takimin me kreun e Kuvendit Gramoz Ruçi u diskutua mbi pozicionin e Shqipërisë për dialogun Kosovë-Serbi.

"Shqipëria ka qenë që në krye të herës mbështetëse pa rezervë e dialogut Kosovë-Serbi të lehtësuar nga BE. Në vlerësimin tonë, kjo është platforma e duhur për normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve dhe farkëtimin e destinacionit të tyre evropian", u shpreh kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, në konferencën e përbashkët me Veselin. "Dialogu është mekanizmi më i efektshëm për të siguruar një zgjidhje të qëndrueshme, që do të garantojë zbatimin e marrëveshjeve të arritura dhe, mbi të gjitha, njohjen e ndërsjellë mes dy vendeve, përmes një dokumenti ligjorist të detyrueshëm, siç përcaktohet në Strategjinë e Komisionit Evropian. Ne presim dhe inkurajojmë të gjithë aktorët e përfshirë që kjo zgjidhje të jetë e drejtë, e pranueshme, afatgjatë dhe në interes të Kosovës dhe gjithë Rajonit", tha më tej, Ruçi. "Apeli im është që aktorët dhe faktorët institucionale dhe forcat politike të

jenë në unitet për këtë çështje kaq të rëndësishme", -u shpreh kreu i Kuvendit, Gramoz Ruçi. Edhe në takimin me kreun e PD-së, Lulzim Basha në qendër të bisedës ka qenë unifikimi i faktorit kosovar, në rajon, por edhe në Tiranë. Po ashtu

lideri i demokratëve nga selia e PD-së tha se duhet të respektohet parimi i moscenimit të kufijve. "Theksi në këtë kohë sfidash për Kosovën dhe rajonin është uniteti. Por edhe bashkimi i faktorit të Kosovës, por dhe të Tiranës, për t'i

shërbyer interesit kombëtar, interesit të popullit të Kosovës që është sovran. Duhet parimi i pacenueshmërisë se kufijve, dhe përcaktimi i qartë i Kosovës si anëtare në NATO dhe në BE, rruga e të cilës kalon përmes reformave. PD ka mbështetur dhe mbështet dialogun midis Kosovës dhe Shqipërisë në funksion të normalizimit të dy vendeve", -tha Basha. Ndërkohë, Veseli pohoi në fjalën e tij se Kosova nuk ka si qëllim që të marrë kufijtë nga të tjerët, ndërsa shtoi se shumë prej qytetarëve të saj do të kenë brengë. "Duhet sa më shpejt platforma kombëtare, për dialogun me Serbinë. Vullneti i qytetarëve është Kosova të pranohet në OKB, e të ecë në rrugëtimin drejt BE e NATO, të ketë raporte të mira me fqinjët. Qëndrimet janë të qarta dhe në duhet të punojmë bashkërisht. Partitë në Shqipëri janë përkrahësit më të mëdha të shtetit tonë. Kjo është e ardhmja jonë, një Ballkan stabil, i integruar ku jetohej në fqinjësi të mirë, pa hyrë në punët e njëra tjetrës. Kosova nuk do të marrë nga të tjerët, është shtet sovran dhe do të angazhohet për të drejtat e shqiptarëve kudo që janë. Punojmë për stabilitetin rajonal, nuk kemi pretendime ndaj asnjë shteti, por kemi brengë për qytetarët tanë. As abetaret nuk lejohet të futen në shtetin serb", -tha Veseli.



Berisha: Partitë kosovare të ulen bashkë të votojnë dokumentin e dialogut

Ish-kryeministri Sali Berisha priti dje, zëvendëskryeministrin e Kosovës, Fatmir Limajin dhe kreun e Kuvendit, Kadri Veselin, me të cilët ka diskutuar për çështjen e kufijve me Serbinë. Berisha është shprehur se dënon me forcë çdo përpjekje të Beogradit për destabilizimin dhe i kërkoi ndërkombehtarëve që të kuptojë se Vuçiq është një Milosheviç i vërtetë. "Marrëveshja Kosovë-Serbi është e një rëndësie të madhe. Ndaj mendimin se integriteti territorial i Kosovës nuk mund të jetë çështje diskutimi. Denoncoj me forcë përpjekjet e Beogradit për një Republikë Serpska, është një përpjekje për destabilizimin. Thirrja ime për të gjithë partitë në Kosovë, të ulen së bashku të votojnë në parlament dokumentin, korinzen e këtij diskutimi dhe delegacionin e përbashkët. Nevojitet një kuadër ligjor që mos ketë debate. Vuçiq erdhi me dy flamuj, me flamurin e Serbisë së Milosheviçit dhe flamurin e Vaso ?ubrilovi?. I bëj thirrje komunitetit ndërkombehtar të kuptojë vizitën e tij, të këtij qaramani që bën viktimitëm po ai është një Milosheviç i vërtetë", -tha Berisha. Nga ana e tij, kreu i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli tha se Kosova është shtet i pavarur sovran dhe se të bashkuar pozitë-opozitë nuk i sfidon askush. "Kosova është një dhe askush nuk mund ta ndajë Kosovën, nëse në jemi bashkë pozitë e opozitë. Nëse jemi bashkë nuk na sfidon askush. Në dialog shkojmë jo nga dashuria për Serbinë, por duhet një liri e qëndrueshme një paqe e qëndrueshme. Kosova ka nevojë të jetë bashkë", -tha Veseli.



TAKIMI ME LU

Ish-kryeministri Sali Berisha e ka akuzuar vazhdimisht ambasadorin amerikan në Tiranë, Donald Lu si të korruptuar, në konflikt interesi dhe me një sjellje tipike prej "guvernatori". Por duket se meritë mes tyre janë shuar. Berisha ka pritur dje, në një takim para largimit nga Shqipëria ambasadorin Donald Lu.



Ministri i Jashtëm shqiptar, vizitë në Maqedoni

Bushati takon Zaev: Shqiptarët t'i thonë "po" referendumit

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati u bëri thirrje shqiptarëve në Maqedoni të votojnë "pro" referendumin. Gjatë një vizite në Maqedoni Bushati takoi kryeministrin e Maqedonisë, Zoran Zaev. Biseda u përqendrua tek zhvillimet më të fundit në Maqedoni dhe rajon si dhe sfidat e përbashkëta me të cilat përballë Ballkanit Perëndimor. Ministri Bushati vlerësoi liderimin politik të Kryeministrit Zaev, i cili ka ndërmarrë një qasje të re ndaj fqinjëve për të drejtuar vendin drejt anëtarësimit të plotë në BE dhe NATO. Sipas ministrit Bushati, çelësi i vetëm për hapjen e kësaj rruge është vota PRO Marrëveshjes së Prespës në referendumin e datës 30 shtator. Në këtë kuadër, kreu i diplomacisë shqiptare inkurajoi të gjithë qytetarët e Maqedonisë të ushtronjë të drejtën e tyre demokratike për të jetësuar në perspektivën e tyre euro-atlantike. "Është detyrë historike e çdo qytetari shqiptar në Maqedoni dhe në diasporë të votojnë masivisht dhe t'i thonë JO Marrëveshjes në Referendum. Po ashtu, është misioni politik i të gjithë spektrit politik shqiptar të shfaqë unitet për të mobilizuar votën masive shqiptare më datë 30 shtator", nënvizoi ministri Bushati. Të dy zyrtarët u ndalën dhe tek nevoja e hyrjes sa më shpejt në fuqi e ligjit të gjuhëve. Mbi këtë çështje, palët ndanë bindjen se zbatimi i duhur i tij dhe krijimi i shpejtë i mekanizmave të monitorimit siguron një qasje më të mirë dhe më të drejtë ndaj shërbimeve për shqiptarët dhe përfshirjen e tyre në qeverisjen e mirë, politikën e zhvillimit dhe ndërtimin e një shoqërie të hapur, gjithëpërfshirëse dhe të orientuar drejt Europës.



REPUBLIKA E SHQIPERISE BANKA E SHQIPERISE DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes së sistemeve të kondicionimit në dhomat e serverëve dhe arkivës së Bankës së Shqipërisë"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 1,388,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallit", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes së sistemeve të kondicionimit në dhomat e serverëve dhe arkivës së Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 05 Tetor 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Gjyshi: Nëse ish-dhëndri im është fajtor, kërkoj dënimin e tij me burgim të përjetshëm

Akuza: Përdhunoi vajzën 16 vite, babai: Ish-gruaja do marrë shtëpinë

Qirjako Nakuçi: Më rrahën për të pranuar ngjarjen

TIRANE

Qirjako Nakuçi, 61-vjeçari i arrestuar pas akuzave nga vajza e tij se e ka përdhunuar prej 16 viteve, mohon akuzat. Historia dramatike e 25-vjeçares nga Tirana ishte ditën e djeshme në fokus të emisionit 'Me zemër të hapur'. Në një lidhje telefonike për emisionin 61-vjeçari pohoi se ishte i pafajshëm dhe se nuk e kishte prekur kurrë me dorë vajzën. Ai tha se vajza kishte dashur të qëndronte vetë me të në një banesë dhe jo me nënën. "Nuk e kam përdhunuar unë vajzën time. Gënjën ish-gruaja bashkë me vajzën që të më marrin shtëpinë", deklaroi nga burgu i Vaqarrit Nakuçi. Fillimisht gjyshi i të resë, 81-vjeçari me inicialet M.SH. i pranishëm në emision pohoi se ngjarjen e rëndë e kishte mësuar nga televizioni, ndërsa shtoi se nuk kishte qenë në dijeni të abuzimit. Po ashtu i moshuari tha mes lotësh se nuk e kishte takuar vajzën, pasi ajo ishte në mbrojtje nga policia. Teksa i rikthehet pas historisë së martesës së vajzës së tij me ish-dhëndrin, i moshuari tregon se 61-vjeçari nuk kishte qenë kurrë i përgjegjshëm. Ai tha se pasi kishte përzënë dy fëmijët tek ish-gruaja, kishte mbajtur vetëm të madhen. I moshuari e mbylli fjalën e tij me një apel, ndërsa shtoi se kërkonte burg përjetë për ish-dhëndrin nëse ai do shpallej fajtor. Por nëpërmjet lidhjes telefonike Nakuçi mohoi akuzat e ish-vjehrrit të tij që ndodhë në studion e emisionit. Po ashtu ai akuzoi live ish-gruaja dhe vajzën se gjithëka po bëhet për t'i marrë shtëpinë. Mes të tjerash ai lëshoi akuza kundër policisë së kjo e fundit e ka dhunuar fizikisht, ndërsa e ka detyruar sipas tij që të firmosë deklaratën se e kishte përdhunuar vajzën.



Gjyshi i 25-vjeçares në emisionin 'Me zemër të hapur'

"Mbesa ime kishte shoqëri vetëm me të atin. Dilnin dhe në orë të vona, madje dhe kur takoheshim në rrugë, s'më flisnin. Ajo rrinte në shtëpi, nuk punonte, rrinte nën kontrollin e tij. Nëse ish-dhëndri im është fajtor, kërkoj dënimin e tij me burgim të përjetshëm", - tha i moshuari.

e madhe, se ajo i interesonte. Ai ia mori fëmijët me zor. Shkoi vajza që ta merrte gocën, dhe ai nuk ia dha. Në atë kohë vajza ka qenë 12-13 vjeçe. Vajza nuk vinte tek nëna, se nuk e linte. Gruaja ime ua çonte ushqimin tek banesa. Ajo i takonte fshehurazi motrën dhe vëllain, por nënën jo. Vajza ime e ka takuar fshehurazi çupën e saj. Para ca vitesh mbesa e ka denoncuar në polici atë dhe ai u arrestua. Ai ishte i pasjellshëm dhe sillte keq me vajzën time. Ai vidhte dhe merrej me poshtërsira. Më kapi një njeri dhe më tha; më ka marrë dhëndri

QIRJAKO NAKUÇI

"Gruaja dhe vajza e bëjnë të më bëjnë mua me turp. Duan të më marrin atë copë shtëpi. Këtë e di gjithë lagjja, edhe shteti. Unë nuk kam ushtruar dhunë asnjëherë. Policia më rrahu dhe më detyroi që të firmosja ato që janë thënë, ç'kanë dashur. Unë u detyrova dhe firmosa se nuk shoh", - u shpreh Qirjako Nakuçi.

jet 18 mijë lekë. Ia dhashë unë lekët. S'jami marrë kurrë vesh me të. Ushqimet ia çonim ne gati vajzës, se ai nuk u siguronte asgjë. Vajza ime kur e mori vesh u shqetësua shumë. Ajo tentoi të takonte vajzën, por ajo rri tek murgeshat. Mbesa ime kishte shoqëri vetëm me të atin. Dilnin dhe në orë të vona, madje dhe kur takoheshim në rrugë, s'më flisnin. Ajo rrinte në shtëpi, nuk punonte, rrinte nën kontrollin e tij. Nëse ish-dhëndri im është fajtor, kërkoj dënimin e tij me burgim të përjetshëm",-tha i moshuari.

REAGIMI I BABAIT

"Dua të them se gjyshi i vajzës, ish-vjehrrin im duhet të përgënjeshtrojë ato që thotë. Unë gjatë gjithë vitit i kam mbajtur vetë fëmijët me hekura dhe kanoçe. Edhe pse ato duhet t'i mbante vetë vajza se unë e kam mbajtur. Kur është dhënë lajmi se unë kam përdhunuar vajzën 9 vjeç, nuk ishim ndarë. Si ka mundësi që nuk ia ka



Faksimile e përgjigjes së prokurorisë për procedimin penal ndaj Qirjako Nakuçit

"Dua të them se gjyshi i vajzës, ish-vjehrrin im duhet të përgënjeshtrojë ato që thotë. Unë gjatë gjithë vitit i kam mbajtur vetë fëmijët me hekura dhe kanoçe. Edhe pse ato duhet t'i mbante vetë vajza se unë e kam mbajtur. Kur është dhënë lajmi se unë kam përdhunuar vajzën 9 vjeçe, nuk ishim ndarë. Si ka mundësi që nuk ia ka thënë vajza se unë e kam përdhunuar.

shtëpia. Më pas mësova se vajza më kishte denoncuar",-tha ai.

HISTORIA

Për 16 vite me radhë ajo heshti, por një ditë u gjend e dobët dhe tregoi historinë e saj të maktit. 61-vjeçari Qirjako Nakuçi u arrestua pas denoncimit që bëri e bija. Abuzimi ka vazhduar prej vitesh, që kur ajo ka qenë vetëm 9

ARRESTIMI

61-vjeçari që u arrestua mëngjesin e 30 gushtit fillimisht ka mohuar ngjarjen, më pas e ka pranuar atë pjesërisht, duke thënë se nuk ka abuzuar me vajzën kur ajo ka qenë e mitur. Pasi ka pranuar incestin në moshë madhore me vajzën, ai e ka ndarë "fajin" me të bijën, duke thënë se nuk ka ndodhur pa dëshirën e saj.

vjeçe. Kanë qenë murgeshat ato që kanë zbuluar ngjarjen, kur e reja ka rrefyer ferrin e përjetuar gjatë viteve që ka qëndruar me babain. Qirjako Nakuçi, u divorcua me gruan në vitin 2002 dhe nëna e tyre pas divorcit u largua nga shtëpia, ndërsa fëmijët ai ia mori me forcë. Në vend të përkujdesjes për fëmijët, babai ka abuzuar me vajzën e madhe, në atë kohë 9 vjeçe, sot 25 dhe vetë ai 61-vjeçar. Skenat e marrëdhënies seksuale me dhunë kanë ndodhur brenda dhomës që ata e quanin shtëpi, kur në banesë nuk ndodheshin edhe dy fëmijët e tjerë. Historia e tmerrshme, sipas kallëzimit të vajzës, nis një ditë kur babai i saj në gjendje të dehur kreu marrëdhënie seksuale me dhunë në të, në atë kohë ishte vetëm 9 vjeç. Nga ajo ditë nuk u ndal më së abuzuari me të. 61-vjeçari që u arrestua mëngjesin e 30 gushtit fillimisht ka mohuar ngjarjen, më pas e ka pranuar atë pjesërisht, duke thënë se nuk ka abuzuar me vajzën kur ajo ka qenë e mitur. Pasi ka pranuar incestin në moshë madhore me vajzën, ai e ka ndarë "fajin" me të bijën, duke thënë se nuk ka ndodhur pa dëshirën e saj. Megjithatë, ai është vënë në pranga nga policia për tri vepra penale. "Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari", "Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur" dhe "Dhunë në familje".

Kolegji i Posaçëm i Ape-
limit nxori jashtë
radhëve të sistemit të
drejtësisë, prokuroren e
Apelit të Shkodrës, Besa
Nikëhasani. KPA vlerësoi
të ligjshëm shkarkimin e
prokurores Nikëhasani
seancën e 20 prillit pasi
nuk justifikonte pasurinë.
Trupa e KPA përbëhej nga
Sokol Çomo, relatorja Al-
bana Shtylla dhe anëtarë:
Rezarta Schuetz, Natasha
Mulaj dhe Ardian Hajdari.
Nikëhasani u vetua me për-
parësi, për shkak se kandi-
donte për Këshillin e Lartë
të Prokurorisë, por nuk ia
doli të kalonte me sukses
filtrin e trefishtë të kon-
trollit. Nga hetimi admin-
istrativ rezultoi se subjek-
ti nuk justifikonte dot pa-
surinë dhe kishte mungesë

"Prokurorja e Apelit të Shkodrës nuk justifikon pasurinë"

Vetingu, KPA vlerëson të ligjshëm shkarkimin e Besa Nikëhasanit


VENDIMI

KPA vlerësoi të ligjshëm shkarkimin e prokurores Nikëhasani në seancën e 20 prillit, pasi nuk justifikonte pasurinë. Trupa e KPA përbëhej nga Sokol Çomo, relatorja Albana Shtylla dhe anëtarë Rezarta Schuetz, Natasha Mulaj dhe Ardian Hajdari. Nikëhasani u vetua me përparësi, për shkak se kandidonte për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, por nuk ia doli të kalonte me sukses filtrin e trefishtë të kontrollit.

të të ardhurave të ligjshme, konkretisht dy apartamente, dy garazhe dhe një makinë fuoristradë "Toyota Land-

cruse" me vlerë rreth 20 mijë euro. Nikëhasani e kundërshtoi ashpër vendimin dhe hapi i asaj i radhës, ishte pë-

ballja me Kolegjin, betejë të cilën e ka humbur tashtë. Pas seancës së vetingut, jashtë ambienteve prokurorja deklaroi se ka punuar me ndershmëri edhe pse i kanë vendosur edhe tritol në banesë. Ajo theksoi se në fillim në 2003 ka deklaruar vetëm rrogën e saj, pasi nuk e dinte se duhet deklaruar gjithçka. Shkarkimi i Nikëhasanit, fut nën gërc krijimin e institucionit të ri të KPL, kjo për faktin se nga katër kandidatë, tre janë shkarkuar. Luan Kaloci, ishte i



Prokurorja, Besa Nikëhasani

vetmi kandidat për KLP nga prokurorria e Apelit Tiranë. Nëse vendimi për shkarkimin e tij, mbetet në fuqi edhe në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, atëherë prokurorria e Përgjithshme duhet të rihapë garën dhe të ftojë prokurorët të kandidojnë për një vend në institucion-

in e ri që pritet të krijohet në kuadër të reformës në drejtësi. Edhe Bujar Hoti, prokuror në Apelin e Durresit, nuk e kaloi provimin e vetingut, për shkak të probleme me pasurinë. I vetmi kandidat i konfirmuar në detyrë, është prokurori Arben Dollapaj.

Elton Deda: Nuk e di se si është legalizuar kjo shoqatë në gjykatë

Prostitucion nën emrin "Ferdinand Deda", arrestohet kreu i shoqatës

Çekrezi siguronte vajza me qëllim shfrytëzimin e tyre

TIRANË



I arrestuari, Shpëtim Çekrezi

Policia e Shtetit vuri në pranga shtetasin Shpëtim Çekrezi, pasi akuzohet se ka shfrytëzuar vajza për prostitucion në Maqedoni. Kjo nëpërmjet një shoqate artistike me emrin e një prej artistëve shqiptarë. Çekrezi u regjistrua nga emisioni investigativ "Fiks Fare" teksa kryente aktivitet kriminal të shfrytëzimit të prostitucionit. Specialistët e Hetimeve të Paligjshme kanë thënë se u krye arrestimi në flagrancë i Çekrezit, banues në fshatin Dardhë të Librazhdit. Arrestimi i këtij shtetasi është bërë, pasi ky person, kryetar i shoqatës artistike "Ferdinand Deda" siguronte vajza në Tiranë me qëllim shfrytëzimin e tyre për prostitucion në shtetin fqinj, Maqedoni. Ndërkohë pak ditë më parë përmes një reagimi në rrjetin social "Facebook", i biri i Ferdinand Dede, Elton Deda ngriti shqetësimin se si kjo shoqatë është legalizuar në gjykatë. "I dashur Baba, Nder i Kombit dhe muzikantit gjeni. Më në fund të erdhi edhe ty radha që në 15-vjetorin e vdekjes, të dalësh në TV, jo me baketë në tendë në dorë, por fytyra jote e pashme e stampuar në një vule shoqate, e cila merret me prosti-

tucion dhe eskorta. Se si është legalizuar kjo shoqatë në gjykatë nuk e di, por me siguri kanë harruar të kërkojnë pëlqimin tënd meqenëse ti ke lëvizur për pak kohë jashtë shtetit. Gjithashtu, edhe për ne

familjarë t e tu, harruan të na kërkojnë një autorizim të përkohshëm derisa të vijë ti. Meqë të erdhi shorti në majë të hundës dhe vendose të mos ktheheshe, këta vendosë n të të kujtojnë duke të respektuar dhe duke i vë

në emrin tënd të nderuar një shoqate. Mbese po të kishe vendosur të rrije edhe mund të kishe përfutur diçka në dorë, pa zhurmë dhe mbese kishe mbyllur ndonjë vrimë në portofol. Të premtoj që do bëj ç'është e mundur (pasi e di që shumëpak prej baballarëve të kombit do t'u interesojë ta ndjekin këtë të çështje), ta heq përjetësisht fytyrën tënde të hijshme nga ajo vullë dhe nga ai aktivitet i ndyrë. Do flasim pra për Babë, qëndro i fortë! Yt bir", shkruan i biri Elton Deda. Sakaq Shpëtim Çekrezi do të përballlet me veprën penale: "Shfrytëzim prostitucioni". Grupi hetimor vijon punën për të zbardhur gjithë skemën si funksiononte grupi që merret me aktivitetin e jashtëligjshëm.

SHKURT

Tentoi të vrasë me armë nipin, arrestohet khaxhai në Kurbin

KURBIN- Policia e Kurbinit ka vënë në pranga ditën e djeshme një 59-vjeçar, i cili tentoi të vrasë nipin e tij. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se Preng Teska tentoi që të vrasë me armë zjarri nipin e tij, shtetasin A.T. 22 vjeç. Atij i është sekuestruar një pushkë me një karikator me 10 fishekë. "Nga forcat policore të Komisarariatit të Policisë Mirditë, pas telefonatës tek Salla Operative se në Krëshen kishte një konflikt me përdorim armë zjarri, falë një pune hetimore dhe operacionale të mirëfilltë, është bërë ndërhyrja në kohë rekord duke parandaluar një ngjarje kriminale të mundshme, ku në bashkëpunim me Komisarariatin e Policisë Kurbin, arrestuan në flagrancë shtetasin Preng Teska, 59 vjeç, banues në Kurbin. Ky shtetas, pas një konflikti të castit për motive të dobëta, ka tentuar të vrasë me armë zjarri pushkë, nipin e tij, shtetasin A.T. 22 vjeç, banues në Krëshen", thuhet në njoftimin e Policisë.

Në kërkim për dhunë e abuzim seksual, kapet 41-vjeçari kosovar

KUKËS-Një shtetas kosovar ka rënë në prangat e policisë së Kukësit, pasi kërkohet për dhunë në familje, kërcënim dhe marrëdhënie seksuale me dhunë. Burime zyrtare bënë me dije se Astrit Koçi, 41 vjeç, banues në Prizren u arrestua me qëllim ekstradimit drejt Italisë, pasi ishte dënuar me 4 vite e 8 muaj burg. Koçi u kap në hyrje të SPK, ku gjatë përpunimit të dokumentacionit rezultoi person në kërkim ndërkombëtar. Autoritetet gjyqësore të Bellunos Itali, më datë 24.10.2007, e kanë dënuar këtë shtetas me 4 vite e 8 muaj burg për veprat penale "Dhunë në familje", "Marrëdhënie seksuale me dhunë" dhe "Kanosja".

Parandalimi i aksidenteve:

Ndëshkohen 36 drejtues mjetesh

TIRANË- Për të parandaluar aksidentet dhe për të rritur sigurinë në rrugë, policia rrugore ka përfuruar masat. Sipas policisë shqetësim mbetet rreziku i ndalimit të mjeteve të transportit, që qarullojnë në rrugën Tiranë-Durrës, pasi ndalojnë pa kriter pasagjerët përgjatë itinerarit. Policia bëri me dije se ka ndëshkuar 36 drejtues mjetesh, që u kapën në shkelje. "Nisur nga shqetësimet dhe rreziku permanent që shfaqin mjetet e shërbimit publik që nuk respektojnë rregullat e qarqullimit gjatë transportit, kryesisht në rrugën interurbane kryesore "Tiranë-Durrës" dhe anasjelltas, duke ndaluar jashtë stacioneve të miratuara për marrjen dhe zbritjen e pasagjerëve përgjatë itinerarit, Policia Rrugore e Tiranës organizoi disa pika kontrolli në lëvizje me qëllim monitorimin e kësaj kategorie mjeteve në ato vende ku haset më së shumti ky fenomen i rrezikshëm", thuhet në njoftimin e policisë.

U arrestua për 2.4 tonë kanabis, ndërron jetë në QSUT Demo Progonati

Progonati po gjykohej nga gjykata e Krimeve të Rënda me akuzën e trafikut ndërkombëtar të drogës. Progonati u arrestua në janar të 2017, si organizator i trafikut të 2.4 tonëve kanabis drejt Italisë. Ai ishte

sofer i kamionit ku u kap sasia e lëndës narkotike. Gjykata ka pushuar hetimet për Progonatin, ndërsa vijon procesi për të akuzuarit e tjerë nga drejtësia si grup i strukturuar kriminal.

Ka ndërruar jetë në QSUT Demo Progonati, i arrestuar në datë 15 janar 2017 për trafik droge.

46-vjeçari akuzohet se trafikoi 2.4 tonë kanabis drejt Italisë. Mësohet se Progonati ka ndërruar jetën në muajin qershor, por lajmi është bërë i ditur ditën e djeshme, ndërsa ende nuk dihet sëmundja nga e cila ai vuante. Demo

Përmbaruesi Gjyqësor Privat Z. Medar Kajolli, njofton shpalljen për shitje në ankand të Tretë për pasuritë e paligjshme si më poshtë:

- Pasuria Nr. 250/3-1-2, Vol. -31, fq. -234, Z.K-1791, Apartament me Sip.-209.7 m2, në vlerën **4756'000** (Katër milion e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) Lekë.
- Pasuria Nr. 250/3-1-3, Vol. -31, fq. -235, Z.K-1791, Apartament me Sip.-209.7 m2, në vlerën **4756'000** (Katër milion e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) Lekë.
- Pasuria Nr. 211/11, Vol. -4, fq.-201, Z.K-1791, Illoj Aëri me Sip.-500 m2, në vlerën **252'000** (Dyqind e pesëdhjetë e dy mijë) Lekë.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 03.10.2018, në orën 16.00, në ambientet e zyrës së Përmbaruesit Gjyqësor Privat Z. Medar Kajolli, me adresë: Rruga "Urani Pano", Pll-1/3, Kati -2, Tiranë. Cet. 069 73 23 003, email: medar.kajolli@yahoo.com

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

A. Pasuria nr. 26/ 319, e llojit 'truall', vol. 27, fq. 207, zk. 8642, sip. 10.000 m2, ndodhur në Sarandë, në pronësi të GRIGOR TAVO;

B. Pasuria nr. 26/ 320, e llojit 'truall', vol. 27, fq. 208, zk. 8642, sip. 10.000 m2, ndodhur në Sarandë, në pronësi të GRIGOR TAVO;

ÇMIMI 78.976.000 LEKË për secilën pasuri; në Total 157.952.000 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë **26.09.2018**.
CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

SHPALLJE ANKANDI

DATE 18.09.2018, ORA 16.00

Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Str. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 040450426, Cet. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.

Shpall ankandin e dytë për pasuritë e paligjshme të dëbltorit Agron Shëfqet Burhani dhe dorëzancës Halilho Shëfqet Burhani:

- Apartament banimi + Truall' me sipërfaqe 62 m2, me nr. pasurisë 14/301, zona kadastrale 3574, regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 2561 datë 07.10.1994, adresë: Luga '15 Shtator', pallati 53, shkalla 1, apartamenti 4, Topolena.

Cmimi fillestar i ankandit të dytë është në shumën 896 000 (steqind e nentëdhjetë e gjashtë mijë) lekë. Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Str. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

Operacioni "Forca e Ligjit", sekuestrohen armë dhe municione

RENEA dhe FNSH mësyjnë në Nikël me autoblanda, arrestohen pesë persona

Zona, 5 orë në shtetrrethim, mes të arrestuarve vëllai i Durim Bamit dhe i "forti" Ylli Çangu

KRUJË

Fshati Nikël i Krujës, ku prej vitesh kanë bërë ligjin të "fortët" është zgjuar mëngjesin e djeshëm në shtetrrethim policor. Policia e Shtetit ka zhvilluar një operacion të befashëm në fshatin e të ashtuquajturit "grup i Niklës", i përfshirë në një seri ngjarjesh kriminale në harkun kohor të 20 viteve. Operacioni, i cili drejtohej nga kreu i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu dhe ku morën pjesë dhe FNSH e RENEA ka nisur në orën 04:00. Ky operacion u finalizua me shoqërimin e 11 personave, ku disa prej të cilëve janë emra të njohur për policinë si pjesëmarrës në disa ngjarje të rënda që nga gjobëvënja, vjedhjet e atentatet me tritol. Ndërkaq, mbrëmë në orët e vona, burime zyrtare nga policia dhe prokuroria bënë me dije se nga 11 personat që u shoqëruan, vetëm 5 prej tyre u arrestuan, ndërsa të tjerët u lanë të lirë pas marrjes në pyetje. Mësohet se shtetasit e arrestuar janë Lutfi Haka, Marklen Haka, Ylli Çangu, Skënder Leza dhe Valter Bami, vëllai i Durim Bamit, i cili trazoi politikën shqiptare me atentatin e pretenduar ndaj deputetit Tom Doshi.

OPERACIONI

Forcat e policisë dhe ato speciale kanë hyrë në fshatin Nikël të Krujës me autoblanda, ndërsa mësohet se në tarracat e ndërtesave janë vendosur snajpera për të parandaluar ndonjë reagim nga personat e kërkuar, pasi dyshohej se ishin të armatosur. Vilat e të "fortëve" kanë qenë shënjestra e kontrollit policor në kuadër të operacionit "Forca e Ligjit". Për t'i kapur mat brenda banesave, policia ka përdorur një truk të vogël, duke lënë Niklën në errësirë totale, pasi kishte pikasur vilat ku do të ndërhyhej. Në operacion morën pjesë një numër i madh efektivësh policie (mbi 100) të shoqëruar me 20 mjete të blinduara. 11 personat e shoqëruar u dërguan në ambientet e policisë së Durrësit, ku dhe u morën në pyetje.

ARRESTIMET

Burime nga prokuroria pohuan se në vazhdim të operacionit policor të koduar "Forca e Ligjit", forcat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit në bashkëpunim me forcat e Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, nën



Operacioni i djeshëm në Nikël



PERSONAT E ARRESTUAR GJATË OPERACIONIT NË NIKËL

1. Lutfi Haka, 67 vjeç, banues në fshatin Zezë të Rrethit Krujë, arsimi 4 klasë, i dënuar më parë.
2. Marklen Haka, 27 vjeç banues në Zezë të rrethit Krujë, arsimi 8 klasë, i dënuar më parë.
3. Ylli Çangu, 42 vjeç, banues në fshatin Nikël të rrethit Krujë, arsimi 12 klasë, i padënuar më parë.
4. Skënder Leza, 34 vjeç, banues në fshatin Larushk të rrethit Krujë, me arsim 4 klasë, i dënuar më parë.
5. Valter Bami, 32 vjeç, banues në fshatin Larushk të Rrethit Krujë, me arsim 4-vjeçar, i padënuar më parë.

drejtimit e hetimeve të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë, lidhur me gjetjen dhe sekuestrimin e sendeve të kundraligjshme, bënë ekzekutimin e vendimeve për kontrollin e banesave të shtetasve: Durim Bami, Valter Bami, Genc Pajtoni, Ylli Çangu, Marklen Haka, Bedri Haka, Skënder Leza, Flamur Haka dhe Zyber Bami, ku në përfundim të kontrolleve u bë arrestimi në flagrancë i pesë prej tyre. Mësohet se gjatë kontrollit të ushtruar në banesat e personave që u vunë në pranga u gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provave materiale: një armë zjarri pistoletë e markës "Bereta" me nr. L95899Z, një armë zjarri revolver "Trident" me nr. 10883; 28 fishekë luftarakë, kalibër 9 mm; tri armë gajhu dhe një pushkë sportive pleumatike.

Spitali: Lindi me sindromën e rrallë

Vdes foshnja në Durrës, familjarët akuza mjekëve



sive, në mënyrë konsultative. Sipas mjekut operator, ekstraksioni i fetusit paraqiti

vështirësi dhe u vu re gjatë lindjes frakturë femorale dhe humerale, vërtetuar


edhe me grafi. Sipas drejtorisë së spitalit Durrës, stafi mjekësor ka dhënë trajtimin maksimal, në konsultë me ortopedët dhe shërbimin tercial, por fatkeqësisht fëmija ka qenë në gjendje të rëndë dhe nuk ka arritur të mbijetojë. Sipas mjekëve, foshnja dyshohet të ketë pasur një sëmundje të rrallë gjenetike, anomali skeletike kongenitale, që mund të vlerësohet nga autopsia. Ndërkohë, është duke u kryer autopsia, e cila do të japë dëshmi shkaqet e vdekjes së foshnjës.

Pagesat e kryera për fondin e kompensimit janë 541 milionë

Ornela Manjani

Dëmshpërblimet e aksidenteve, 923 milionë lekë detyrime të prapambetura

Koçi: U shlye 59% e borxhit të akumuluar prej vitit 2002



AMF i ka lënë afat ko mpanive të siguri meve të shlyejnë detyrimet e prapambetura të aksidenteve rrugore deri në 1 janar. Drejtori i institucionit Ervin Koçi është shprehur se me reformat e ndërmarra është bërë e mundur të paguhet 59 për qind të detyrimeve, të cilat ishin akumuluar deri prej vitit 2002. Detyrimet e prapambetura të aksidenteve vijojnë të mbeten problem për qytetarët shqiptarë. Gjatë raportimit në komisionin e Ekonomisë dhe Financave Drejtori i AMF, Ervin Koçi theksoi se deri në datë 10 shtator 2018 shoqëritë e sigurimit kanë kryer 59% pagesave të dëmeve të prapambetura nga Fondi i Kompensimit, që arrin në rreth 541 milionë lekë dëmshpërblime. "Për vitin 2018 është rreth 1.67 miliardë lekë ku 923 milionë lekë janë detyrime të prapambetura, të cilat janë për t'u ekzekutuar dhe 745 milionë lekë janë për ngjarjet e sigurimit që janë në proces trajtimi apo proces gjyqësor që nuk kanë ende vendim të formës së prerë. Pagesat e kryera deri tani nga të gjitha shoqëritë për fondin e kompensimit janë 541 milionë lekë ose 59% e vlerës së përcaktuar me vendimin e Bordit për detyrimet e prapambetura" -tha Koçi në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit të Shqipërisë lidhur me ecurinë e problematikës së Fondit të Kompensimit. Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, Ervin Koçi theksoi se gjatë vitit 2018, ashtu si dhe gjatë vitit të kaluar, Autoriteti i Mbiqëqyrjes Financiare i ka kushtuar një vëmendje të

pushtetar merr paratë. Dhe në fund fare duke lënë dhe pjesë. Ky është turp", -tha Braçe. Fondi i Kompensimit i miratuar nga Bordi i Autoritetit për vitin 2018 arrin në rreth 1.68 miliardë lekë.

RAPORTI

Drejtes të Autoritetit të Mbiqëqyrjes Financiare informuan sot Komisionin e Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit të Shqipërisë lidhur me ecurinë e problematikës së Fondit të Kompensimit. Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, Ervin Koçi theksoi se gjatë vitit 2018, ashtu si dhe gjatë vitit të kaluar, Autoriteti i Mbiqëqyrjes Financiare i ka kushtuar një vëmendje të

veçantë evidentimit dhe zgjidhjes së problemeve të trashëguara ndër vite (duke filluar nga viti 2002) me Byronë Shqiptare të Sigurimit. Kreu i AMF-së theksoi se deri në datë 10 shtator 2018, shoqëritë e sigurimit kanë kryer 59% pagesave të dëmeve të prapambetura nga Fondi i Kompensimit, që në vlerë absolute arrin në rreth 541 milionë lekë dëmshpërblime, të cilat janë marrë nga qytetarët e dëmtuar. Gjithashtu, shoqëritë e sigurimit kanë lidhur marrëveshje për të paguar me këste të nënshkruara me palët përfituese/përfaqësuesit ligjor edhe për shlyerjen e detyrimeve në vlerën prej rreth 303 milionë

lekë. Në anën tjetër, AMF, pas ndryshimit të Rregullores në muajin korrik 2018, ka shpërndarë të shoqëritë praktika për shlyerje detyrimesh në vlerën e mbi 95 milionë lekëve. Kjo ecuri pozitive në pagesa vjen pas vendimeve të njëpasnjëshme të Bordit të AMF-së për pagesën e menjëhershme për detyrimet e prapambetura që janë të ekzekutueshme dhe miratimit e Fondit të Kompensimit për dosjet që janë në proces trajtimi, ose gjyqësor. Në muajin nëntor 2017, u miratua një shtesë në Fondin e Kompensimit të vitit 2017, me vlerë 250 milionë lekë, e cila nuk vinte si propozim nga Asambleja e Përgjithsh-

hme e Anëtarëve të Byrosë. Ndërsa në korrik 2018, Bordi miratoi një tjetër shtesë të Fondit të Kompensimit prej rreth 182 milionë lekë, nisur nga vendimet e gjykatave të formës së prerë. Fondi i Kompensimit i miratuar nga Bordi i Autoritetit për vitin 2018 arrin në rreth 1.68 miliardë lekë dhe ky Fond i miratuar nga AMF është më shumë se ai i 3 viteve të marra së bashku, 2014-2016. Nga ky fond i miratuar, 923 milionë lekë janë detyrimet e prapambetura të cilat janë për t'u ekzekutuar dhe rreth 745 milionë lekë janë për ngjarjet e sigurimit në proces trajtimi apo proces gjyqësor pa vendim të formës së prerë. AMF edhe në vazhdim deklaroi se po merr një sërë masash lidhur me inspektimin në vazhdim të BSHS për ndjekjen e zbatimit të vendimeve të Bordit të Autoritetit. Ndryshimet e ndodhura në BSHS me emërimin e drejtorit të ri dhe ndryshimin e rregullores "Për krijimin, logaritjen, financimin, administrimin e Fondit të Kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve", ndryshuar në korrik 2018, i dhanë mundësinë Autoritetit të bëjë ndarjen e dosjeve të prapambetura objekt i Fondin e Kompensimit në rastet kur nuk veprohet nga BSHS.

Borxhi i jashtëm, u rrit me 162 mln euro në tremujorin II

Borxhi i jashtëm i ekonomisë shqiptare u rrit me 162 milionë euro në tremujorin e dytë të këtij viti. Sipas të dhënave nga Banka e Shqipërisë, stoku total i detyrimeve që sektori publik dhe privat në Shqipëri ka ndaj kreditorëve jo rezidentë arriti në 8.11 miliardë euro. Rritja gjatë tremujorit të dytë ka ardhur në pjesën më të madhe nga rritja e borxhit të bizneseve, me 125 milionë euro më shumë. Besohet se efektin kryesor e ka dhënë kredia e Korporatës Elektro-energetike Shqiptare nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Kjo kredi u mor me qëllim zëvendësimit e overdrafteve që KESH kishte pranë bankave tregtare në Shqipëri, me interesin më të ulët. Pjesa tjetër e rritjes së borxhit të jashtëm erdhi nga sektori i bankar, që e rriti stokun e detyrimeve të jashtme me 42 milionë euro. Ndërkohë, qeveria shqiptare e uli lehtë ekspozimin në borxhe jashtë vendit, me 7 milionë euro më pak krahasuar me tremujorin e parë. Në vitet e fundit, rritja e borxhit të jashtëm të ekonomisë shqiptare ka qenë mjaft e moderuar dhe e përqendruar sidomos te qeveria shqiptare. Sektori i bankar dhe ai i privat përgjithësisht nuk ka pasur nevojë për linja financimi nga jashtë, edhe sepse tregu i brendshëm ka qenë përgjithësisht mjaft likuid. Qeveria mban 43% të totalit të borxhit të jashtëm, e ndjekur nga sektori bankar me 17.5% dhe nga sektori privat jo bankar me 17.3%.

Vonesat dhe anulimet e fluturimeve

Balla i kërkon llogari Aviacionit Civil: Çfarë po bëni?

Ndërsa në Komisionin për Integrimin Europian po diskutohet projektligji "Për Kodin Ajror", Taulant Balla ka ngritur shqetësimin e shumë pasagjerëve, kryesisht emigrantë shqiptarë në Itali, por edhe turistë italianë, lidhur me vonesat, anulimet e fluturimeve që lidhin Italinë me Shqipërinë gjatë muajve të sezonit të lartë qershor - gusht dhe dhjetor-janar" -tha Taulant Balla. Sipas Ballës, shqetësimet lidhen me mosrespektimin e të drejtave të pasagjerëve, të cilët duhet të trajtohen në përputhje me nenet 138 dhe 140 të Kodit Ajror të RSH, si edhe aktet nënligjore në ndjekje të tij, për-

katësisht Urdhri i Ministrisë "Për kompensimin dhe asistencën e pasagjerëve në rastin e mospranimit në bord të avionit dhe anulimet ose vonesës gjatë fluturimeve", transpozim ky i Rregullores Evropiane Nr. 261/2004, për rregullat e përbashkëta për kompensimin dhe ndihmën për pasagjerët, në rast anomali në operim prej shoqërive ajrore. Komisioni miratoi propozimin për t'i kërkuar Autoritetit të Aviacionit Civil një informacion të plotë për masat e marra në adresimin e këtij problemi, siç thotë edhe Balla.

katësisht Urdhri i Ministrisë "Për kompensimin dhe asistencën e pasagjerëve në rastin e mospranimit në bord të avionit dhe anulimet ose vonesës gjatë fluturimeve", transpozim ky i Rregullores Evropiane Nr. 261/2004, për rregullat e përbashkëta për kompensimin dhe ndihmën për pasagjerët, në rast anomali në operim prej shoqërive ajrore. Komisioni miratoi propozimin për t'i kërkuar Autoritetit të Aviacionit Civil një informacion të plotë për masat e marra në adresimin e këtij problemi, siç thotë edhe Balla.

Ndërhyhet në rrugët e veriut

Investimi 14.5 mln euro, Gjijnuri: Të zhblllokohet 'bypas'-i i Shkodrës

Rreth 14.5 milion euro është vlera e investimit për disa akse rrugore në zonat veriore të vendit. Aktualisht kanë nisur punimet në akset Shkodër-Muriqan, Melgushë-Mjedë, Ura e Kir-it-Mjedë dhe Lezhë-Shëngjin, ku vlera e investimit shkon në rreth 5.5 milionë euro, ndërsa shumë shpejt pritet të fillojë reabilitimi edhe në aksin Gafë Çelë-Fushë Arrëz me një investim prej 9 milionë euro. Ndërkaq, ministri i Infrastrukturas dhe Energjisë, Damian Gjijnuri dhe kreu i Autoritetit Rrugor, Afrim Qendro inspektoan kantonierin e hapur në aksin rrugor Shkodër-Muriqan. "Ndërhyrja parashikon prishjen e shtresave ekzis-

tuese asfaltike, zëvendësimin e nënshtrësve në çakëll dhe stabilizant, realizimin e të gjitha shtresave të reja asfaltike në të gjithë gjatësinë e rrugës dhe vendosjen e sinjalistikës rrugore e masave të sigurisë si guardrails, vizim termoplastik, sinjalistikë vertikale/horizontale dhe ndërtim të sistemit të drenazhit", -tha Qendro. Gjijnuri tha se fokusi i përmirësimit të infrastrukturës është në dy fronte, së pari, tek ndërtimi i rrugëve të reja dhe përfundimi i atyre të zvarritura prej vitesh dhe së dyti, tek mirëmbajtja. Më tej, ai kërkoi nga Bashkia e Shkodrës që të bashkëpunojë dhe zhbllkojë investimin e qeverisë për bypasin e qytetit. "Ne në Shkodër kemi investime tjera të

rëndësishme siç është përfundimi i unazës së Shkodrës. Unë i bëj thirrje Bashkisë së Shkodrës që t'i japë përfundimisht dritën jeshile të zgjidhjes dhe vazhdim të atij projekti, në bazë të projektit të rishikuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar. Gjetëm dakordësinë dhe takim shpresojmë në dhënie e dritës jeshile nga bashkia për të vazhduar me punimet për bypasin duke eliminuar futjen e kamionëve dhe rëndësën e trafikut brenda qytetit", -tha Gjijnuri. Punimet në aksin Shkodër-Muriqan parashikojnë reabilitimin e plotë të 12 kilometrave në kuadër të programit të përbashkët me Bankën Botërore për mirëmbajtjen me performancë të rrugëve.

KOLEGJI UNIVERSITAR "LUARASI" INTERVISTA

Et'hem Ruka: Na kanë përzgjedhur studentët me 10-ta. Nxitoni për raundin e dytë

Voltiza Duro

Në përfundim të raundit të parë të regjistrimeve, numri i studentëve që kanë përzgjedhur Kolegjin Universitar "Luarasi" ka qenë 4 herë më i lartë krahasuar me një vit më parë. Akreditimi maksimal dhe standardi i lartë i mësimdhënies janë dy nga pikat më të forta që kanë afruar maturanët drejt rrugës së dijes pranë këtij universiteti. Rektori i "Luarasi-t", prof. Dr Et'hem Ruka tregon se studentët që janë regjistruar në raundin e parë, kanë një mesatare të lartë. Kjo dëshmon qartë nivelin elitare të Kolegjit Universitar 'Luarasi'. Një numër i lartë studentësh kanë zgjedhur të vazhdojnë rrugëtimin akademik në fakultetin më të ri pranë universitetit Luarasi, përkatësisht në programet e studimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit. Rektori Et'hem Ruka thekson se për vitin e ri akademik 2018-2019, shumë studentë kanë shfaqur një interes të lartë për të transferuar studimet në universitetin "Luarasi". Deri më tani, rreth 60 të rinj kanë tërhequr dokumentacionin nga IAL-të përkatëse, për të vijuar rrugëtimin e sigurt në këtë institucion të arsimit të lartë. Ruka iu bën thirrje studentëve që në dy raundet në vijim, të regjistrohen në Kolegjin Universitar 'Luarasi', për të siguruar një diplomë të vlefshme në tregun e punës.

Raundi i parë i regjistrimit në universitete ka përfunduar. Si ka vijuar ky proces për Kolegjin Universitar "Luarasi"?

Jemi në përfundim të raundit të parë për regjistrimet në shkollat e larta, një proces që është finalizuar me sukses për universitetin "Luarasi". Herë pas here ne kemi pasur rast të tregojmë rezultatet në rritje të këtij universiteti. Kam kënaqësinë të them se numri i studentëve që kanë zgjedhur "Luarasin" është 4-fishuar në raport me vitin e kaluar, për të njëjtin periudhë. Kjo është një rritje, por është edhe një meritë e këtij institucioni, reputacioni i të cilit ka ardhur duke u rritur. Reputacioni sot nuk fitohet

Përfundon raundi i parë i regjistrimeve, "Luarasi" tejkalon pritshmëritë

Rektori: Numri i regjistrimeve, 4 herë më i lartë se në 2017-ën



Et'hem Ruka, rektori i Kolegjit Universitar 'Luarasi'

STUDENTË TRANSFERIM TË "LUARASI"

"Sipas statistikave tona, numri i të interesuarve ka arritur në 60 që do të lëvizin nga universitetet e tjera për në KU "Luarasi". Sigurisht që është një zgjedhje e mirë dhe është e drejta e çdo studenti shqiptar që të ndërrojë universitetin për të gjetur më të mirin", - shpreh rektori.

60

lehtë, në një botë që është me të vërtetë konkurruese e ka shumë shkolla të larta private që janë ende funksionale.

Si ka qenë niveli i studentëve të regjistruar në këtë universitet gjatë raundit të parë?

Ne kemi marrë të gjitha statistikave të mundshme nga të regjistruarit mbi gjimnazet dhe rrethet nga vijat, mesataren e shkollës së mesme, motivin pse kanë zgjedhur këtë universitet. Këta janë tregues të rëndësishëm që ne i përdorim për ecjen e universitetit para, e jo vetëm për këtë vit të ri akademik. Nga një analizë e thjeshtë që kemi bërë, mund të them se studentët e regjistruar kanë një mesatare të lartë nga nota 8 deri në 10. Ky nivel i lartë i studentëve rrit përgjegjësisë e stafit akademik për t'iu dhënë

atë që kërkojnë dhe meritojnë. Kemi "thithur" një numër të madh profesorësh, doktorësh shkencash, në të tre fakultetet, sepse profesorët e mirë e bëjnë edhe shkollën të mirë. Padyshim që "Luarasi" është një institucion elitare i arsimit të lartë në vend.

Si kanë ecur regjistrimet në Fakultetin e ri të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit?

Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit hapet për herë të parë. Për fat të mirë, numri i të regjistruarve në programet e fakultetit të ri është i barabartë me fakultetet e tjera ekzistuese, pra me Drejtësinë e Ekonomikun, çka tregon se ne me të vërtetë i kemi dhënë tregut një drejtim arsimimi që është shumë i kërkuar në ditët e sotme.

Cili është mesazhi juaj për studentët që tashmë do të jenë pjesë e këtij institucioni të arsimit të lartë?

Është një rast shumë i mirë për të falënderuar të gjithë maturanët që kanë zgjedhur "Luarasin", si dhe prindërit e tyre. Dua t'i garantoj se ëndrrat e fëmijëve të tyre do kthehen në realitet. Vitet e diplomuar te ne do të jenë profesionistë në fushën e drejtësisë, ekonomisë e teknologjisë së informacionit e inovacionit. Të jenë të sigurt se diploma e tyre do të ketë shumë vlerë.

Çfarë u këshilloi maturanëve që do të aplikojnë në raundin e dytë dhe të tretë?

Gjej rastin t'iu bëj thirrje maturanëve të cilët ende kanë shansin që të zgjedhin midis universiteteve, që të përzgjedhin

4

HERË MË SHUMË REGJISTRIME

"Kam kënaqësinë të them se numri i studentëve që kanë zgjedhur 'Luarasin' është 4-fishuar në raport me vitin e kaluar, për të njëjtin periudhë. Kjo është një rritje, por është edhe një meritë e këtij institucioni, reputacioni i të cilit ka ardhur duke u rritur", - thotë Ruka.

pa asnjë mëdyshje 'Luarasin'. Të zgjedhin këtë universitet pasi është një ndër katër më të mirë në vend, i akredituar me 6 vite dhe kjo përkthehet në një diplomë që të çon në një destinacion të sigurt. Unë jam i bindur se maturanët që do ulen për herë të parë në bankat e "Luarasit" do të gjejnë atë që ne iu kemi premtuar në takimet që kemi organizuar në kuadër të këshillimit të karrierës. Më vjen mirë që maturanët na kanë besuar si institucion, për vetë faktin që Luarasi është rritur e do vazhdojë të rritet akoma më shumë.

A ka pasur transferime në këtë institucion arsimor për vitin e ri akademik 2018-2019?

Tani jemi në procesin e transferimit (një periudhë kjo relativisht e shkurtrë), por këtu kanë ardhur studentët nga plot universitetet të tjera, janë interesuar e tashmë janë në procesin e transferimit të dokumentacionit në 'Luarasi'. Sipas statistikave tona, numri i të interesuarve ka arritur në 60 që do të lëvizin nga universitetet e tjera për në KU "Luarasi". Sigurisht që është një zgjedhje e mirë, dhe është e drejta e çdo studenti shqiptar që të ndërrojë universitetin për të gjetur më të mirin duke transferuar kreditet mbi bazën e komisioneve që ne ngremë. Vlen të theksoj se rreth 80 studentët të tjerë që kanë përfunduar bacheloret në universitetet e tjera, kanë zgjedhur "Luarasin" për të vazhduar studimet në nivelin master.

A parashikohen programe të reja studimi në KU "Luarasi" si në nivelin Bachelor edhe në atë master?

Ne kemi në proces disa mastera që presin miratimin nga Ministria e Arsimit, ndërsa për vitin e ardhshëm akademik sigurisht që do të shtojmë programet e studimit në fushën e biznesit, ligjit, dizajnit e turizmit.

Është një rast shumë i mirë për të falënderuar të gjithë maturanët që kanë zgjedhur "Luarasin", si dhe prindërit e tyre. Dua t'i garantoj se ëndrrat e fëmijëve të tyre do kthehen në realitet. Vitet e diplomuar te ne do të jenë profesionistë në fushën e drejtësisë, ekonomisë e teknologjisë së informacionit e inovacionit. Të jenë të sigurt se diploma e tyre do të ketë shumë vlerë.

SPECIALE

VRASJA E HAJDARIT

Motra e Nanos telefonon ambasadën: Si është im vëlla?

Nga Ylli Polovina

Italia, por edhe më gjerë, Europa Perëndimore, kanë një lidhje të ndjeshme të stabilitetit të tyre me gjendjen e qëndrueshmërisë në Ballkan. Plasdarimet minuese këtu veçanërisht shekullin e shkuar kanë qenë tepër të shpeshtë dhe në këtë rol disa herë është gjendur edhe Shqipëria. Karakteristike e këtij ndikimi jo pozitiv racional është se ai ka qenë i minimizuar gjatë dy diktaturave, asaj të Ahmet Zogut dhe të Enver Hoxhës, si edhe mjaft e shprehur përgjatë periudhave me pushtet qendror të pakonsoliduar, siç ajo e pas shpalljes së Pavarësisë dhe e dy luftërave ballkanike dhe botërore e viteve dhjetë. Po ashtu në motet e pluralizmit të parë 1920-1924.

Kjo influencë turbullimi u manifestua edhe kur nisi shumëpartitizmi i dytë shqiptar, me rënien e diktaturës.

Ndërkaq kjo dukuri ka edhe një pamje tjetër fort kurioze: duket sikur paqëndrueshmëria e brendshme e Shqipërisë me në pamje të parë preokupim të gjendjes në vendet fqinje, është krijuar prej vetë kësaj, por çdo ditë e më shumë po përvijohen dëshmi se ka ngjarë kretje e kundërta: forca politike dhe shtetërore përreth nesh kanë përdorur agjentë të tyre veprues për t'i provokuar këto periudha destabiliteti me qëllim dobësimin e përhershëm të saj. Sigurisht edhe si manovër për të fikur zjarret e problemeve të tyre të brendshme.

Një Shqipëri e paqëndrueshme, më së pari për veten e saj, pastaj për të tjerët, u vu në një formë pothuaj "të pastër", laboratorike për t'u vëzhguar dhe studiuar, jo vetëm gjatë trazirës (turborevolucionit) të parë, atij të marsit 1997, por edhe në të dytin, atë të shtatorit 1998.

Duke qenë se këto ditë ky turborevolucion i fundit mbush një lloj përvijotori (Mos goftë!), në këtë mot të 20-të të bëmës së saj të cmendur, po ia riparaqesim lex-

Një rrëfim orë pas ore për ngjarjen e 20 viteve më parë në Tiranë

1998, një shtator shqiptar me turborevolucion, si reagoi shtypi dhe shteti italian



uesit nga vetëm një kënd i përjetuar realisht prej autorit të këtij shkrimi: nga qyteti i Romës.

Si reagoi dhe si ia paraqiti opinionit të vet publik shtypi dhe televizioni italian? Bëhet fjalë për një konsumator aktiv mediatic prej një të tretës së një popullsie prej mbi gjatëdhjetë milionë individësh. Pra, janë shumë. Po ashtu si e kryen këtë shërbim edhe ekranit e gazetave të Tiranës, me ndjekës aktivë dikë më tepër se një milion njerëz. Përgjithësisht këta qenë edhe përjetues të saj që po ndodhte.

13 SHTATOR 1998

Është ora dhjetë e njëzetë e mbrëmjes. Nga një telefonatë në redaksinë e Radio "Kontakt" u mor vesh një vrasje e papritur dhe shumë e bujshme: ajo e deputetit të djathtë Azem Hajdari.

Pas "Kontakt" të gjitha stacionet radiofonike private të Tiranës ndërprejnë emisionet argëtuese. Lajmin e rëndë në fillim e transmetoi "Radio Koha", porse në të flitej jo për vrasje, por për plagosje të Azemit. Menjëherë më vonë, në të gjitha stacionet u transmetua lidhja direkte me Spitalin Ushtarak nga ku u mësuva se

Azem Hajdari dhe një bodigard i tij qenë vranë, ndërsa shoqëruesi tjetër ndodhej në sallën e operimit.

TVSH dhe Radio-Tirana, dy mediat e vetme shtetërore, vazhduan programin e tyre të planifikuar burokratisht.

I pari ekran televiziv që ndërpreu transmetimin për të dhënë njoftimin kobzi ishte "TV A". "Klan" dhe "Teuta" e transmetuan lajmin me titra poshtë ndeshjes "Milan-Bolonjë".

Edicioni special për vrasjen e Hajdarit u përcoll për herë të parë në "Shijak TV" në orën 22:45. Drejtuesi i emisionit të jashtëzakonshëm u paraqiti në ekran i përlotur dhe mundi të fliste e shpjegonte pamjet në transmetim vetëm pas dhjetë minutash. Në orën 23:00 nga ky stacion iu kërkua një intervistë ish-presidentit Sali Berisha, por ky i fundit nuk qe në gjendje të fliste. Atëherë "Shijak TV" transmetoi komunikatën e parë të Partisë Demokratike. Paralelisht me të, "Klan" njoftoi për një mbledhje të jashtëzakonshme të qeverisë.

Në orën 23:18, një gjysmë ore pasi vrasjen e Azem Haj-

darit e kishin dhënë lajmin të gjitha agjencitë më të rëndësishme të botës, e njoftoi edhe agjencia shqiptare e lajmeve ATSH. Televizioni shtetëror e komunikoi lajmin e rëndë në orën 23:43. Në një minutë e gjysmë, përveç zisë që kishte ndodhur, u ngushëllua familja e deputetit të vranë si edhe u lexua një deklaratë për ruajtjen e qetësisë.

Një konferencë e improvizuar shtypi e Sali Berishës u kumtua në "Shijak TV" në orën 23:58. Zëri i kryetarit të Partisë Demokratike dridhej. Ai foli vetëm tre minuta, ndërsa përballë kishte një auditor kryesisht me gra të veshura në zi. Vetëm pas mesnate Berisha mundi të japë një intervistë e gjatë. Përsëri në "Shijak TV".

Deklarata e Ministrisë së Rendit ndërkohë komunikonte: "Sot, më datë 12.09.1998 në Tiranë, rreth orës 21:15, në rrugën "Sere-meid Seid Toptani" në afërsi të selisë së Partisë Demokratike Shqiptare një punonjës i policisë i Komisarariatit Nr.1 ka njoftuar se në afërsi të kinema "Partizani" ka dëgjuar krismë armësh. Salla operative, me të dëgjuar njoft-

imet e punonjësit të policisë, dërgoi menjëherë një autopatrullë të Repartit "Shqiponja" me targë policie TR 517 me Nr.3, punonjësit e së cilës kishin dëgjuar krismë dhe porsa shkojnë në vendngjarje konstatojnë tre persona të shtrirë për tokë dhe disa qytetarë, të cilët po përpqeshin të hipnin në një automjet tip "Benz" ngjyrë e bardhë. Dhe iu dha ndihma e menjëhershme mjekësore. U krijuar grupi hetimor dhe gjatë këqyrjes së vendit u gjet një automatik "Kalashnikov" dhe një armë brezli me silenciator, me dy krehër dhe gëzhoja. Nga verifikimet e bëra në Spitalin Ushtarak, rezultoi se ishte vranë deputeti Azem Shpend Hajdari, si edhe shoqëruesi i tij Besim Çeraj, ndërsa ndodhet i plagosur një shtetas ende i paidentifikuar. Po puaohet për zbulimin e autorëve së bashku me Prokurorinë e Rrethit".

14 SHTATOR 1998, PASQYRA E SHTYPIT ITALIAN

"Corriere della Sera" për ngjarjen e ndodhur në Tiranë përdorte titullin e dukshëm: "Është vranë në Tiranë zëvendësi i Berishës". "Il Giornale" thoshte: "Është vranë më besniku i Berishës". "La Repubblica" bënte të ditur: "Hajdari i konsideruar si shef i ultrave të Partisë Demokratike", "Azem Hajdari, udhëheqësi i 'të ashpërve' të PD-së". "L'Unità": "Është vranë në Tiranë krahu i djathtë i Sali Berishës.

Si u vra? Informacioni që nisën të përhapnin në mëngjesin e 14 shtatorit gazetat kryesore italiane qe: "Corriere della Sera" ("U mitralua ndërsa po delte nga selia e partisë, afër sheshit Skënderbej, më i rëndësishmi i kryeqytetit. Bashkë me të vdiq edhe një nga dy truporjat që nuk i ndaheshin. Tjetri është duke vdekur në spital"); "La Stampa" ("Mbrëmë, ndërsa në Tiranë binte një shi i madh, është vranë në një atentat deputeti Azem Hajdari..."; "La Repubblica" ("Atentatorët



kanë pritur që deputeti të dilte nga selia e Partisë Demokratike dhe e kanë mitraluar nga një veturë që ecte").

Sipas shtypit italian të 14 shtatorit 1998, kush akuzohet si vrasësi i tij?

"La Stampa": "Sali Berisha ka akuzuar një polic si përgjegjës të këtij ekzekutimi dhe e ka lidhur ngjarjen me kryeministrin Fatos Nano, i cili të premtën në mëngjes ishte kthyer nga një vizitë në Portugali. Berisha ka shtuar se vrasësit kanë ikur me një veturë me targën e Vlorës, duke përzërirë kështu drejt për së drejti qytetin e jugut, i cili ishte teatër, vitin e shkuar, i një revolte të armatosur dhe që gjithnjë është cilësuar kështjella elektorale e kryeministrit shqiptar...".

"L'Unità": "Akuzohet qeveria", "Opozita akuzon Nanon". "Në një televizion privat, Partia Demokratike e ish-presidentit Sali Berisha, ka akuzuar policinë se është përgjegjëse e drejtpërdrejtë e vrasjes së liderit të partisë Azem Hajdari dhe e një prej truporjave të tij. Në komunikatë bëhen të njohur disa emra policësh, të cilët pas kimit, kanë ikur në afërsi të selisë së Ministrisë së Brendshme. Sipas të njëjtës komunikatë, vrasësit kanë ikur të hipur në katër vetura me targa të Vlorës, të qytetit të Shqipërisë jugore, i cili vitin e shkuar ishte teatër i kryengritjes që çoi në rrezimin



vetë Berishës. “Corriere della Sera”: “Vrasësit, të mbërritur para selisë së partisë në një autoveturë, pas kryerjes së krimit kanë lënë në vend dy mitraloza kallashnikovë dhe janë larguar të pasqetësuar”.

Referuar shtypit italian reagimi i qeverisë shqiptare ishte ky: “L’Unità” (“Nga Ministria e Brendshme kufizohen të thonë se deri ku kanë shkuar hetimet dhe japin një version krejt tjetër të asaj që ka ndodhur. Kanë qëlluar tre të rinj që kanë ikur me një veturë në drejtim të veriut të vendit...”); “La Stampa” (“Ministria e Brendshme ka thirrur një mbledhje, ndërsa qeveria, me një komunikatë të shpërndarë në Tiranë, e ka cilësuar atentatin ‘një akt të rëndë kriminal’ dhe i ka bërë thirrje popullit që të bashkëpunojë për të kapur përgjegjësit”).

PËRSE DUHET TA KENË VRARË?

“Il Giornale”: “Në javët e fundit, pas arrestimit të gjashtë eksponentëve të ish-qeverisë demokratike, gjendja politike në Shqipëri është bërë shumë e tensionuar dhe Hajdari ishte ndër kryesorët organizatorë të të gjitha manifestimeve në shesh që përditë po zhvillohen në të gjitha qytetet e vendit”, “Midis themeluesve kryesorë të Partisë Demokratike të Sali Berishës, muajt e fundit ishte në krah të ish-kryetarit të sh-

të kaluar u plagos me armë zjarri në sallën e parlamentit nga një deputet socialist”. “La Repubblica”: “Azem Hajdari u plagos në sallën e parlamentit nga një deputet socialist...”. “La Stampa”: “Majin e kaluar Hajdari i shpëtoi një atentati në qytetin verior të Tropojës, prej nga ku ai ka origjinën”.

ORA 11.00

Qeveria në Tiranë ishte në mbledhje kur drejt dritareve shpërthyen breshëritë e para të armëve dhe gurëve. Pastaj zjarri përfshiu makinat që rrethonin godinën e Këshillit të Ministrave. Turma ngjiti shkallët dhe të armatosur e të revoltuar bashkë u futën brenda ndërtesës. Zunë të gjithë katin e parë. Ushtarët e gardës qëlluan vetëm në ajër. Civilët të tjerë krijuan një perde zjarri për të penguar ngjitjen e turmës në katin e dytë.

Pikërisht në një nga sallat e këtij kati po bëhej mbledhja e qeverisë. Disa arritën të vënë këmbë edhe në korridorin e tij të gjatë, por mbrojtësit arritën t’i zbrapsin. Po të hyhej në sallën e mbledhjes së qeverisë bodigardët kishin vendosur të qëllonin në mish të sulmuesve. Ndërkohë prapa godinës tashmë u ishte vënë zjarri të tetë makinave të parkuara aty, shumica të ministrave të futur në mbledhje. “T’i kapim me dorë!” thërriste një demonstrues.

Ndërkohë qeveria kishte ndërprerë mbledhjen dhe kryeministri pati ngarkuar ministrin e Brendshme të shkonte menjëherë në selinë e tij për të administruar situatën. Pastaj Fatos Nano doli nga dera e pasme e godinës dhe iku me makinën e tij të blinduar. Pas tij edhe dy nënkryeministrit, edhe këta me makinat e tyre të padepërtueshme nga plumbat. Ministrat e tjerë bashkë me ushtarët e Gardës morën vrapin drejt derës së pasme të Hotel Rognerit.

Shumë shpejt në katin e parë shpërtheu zjarri, demonstruesit po u vinin flakën zyrave dhe gjithçka je tjetër. Mes kaosit një njeri me megafon u thërriste të tjerëve “doktori ju urdhëron të ktheheni”. Manifestuesit e armatosur dhe



ata duarzhveshë filluan të zbatonin urdhrin e ish-presidentit.

ORA 12.47

Komunikatë shtypi e Ministrisë së Jashtme Italiane: “Kryeministri Romano Prodi e përsëriti ftesën ngulmuese për t’i dhënë fund çdo lloj forme të dhunës, nga cila do palë që mund të vijë. Komuniteti ndërkombëtar do të jetë i përpjekshëm në gjykimin e qëndrimit të cilito që do të ketë lejuar apo inkurajuar përdorimin e dhunës. Kryetari i Këshillit të Ministrave nënvizoi se i takon presidentit të Republikës Shqiptare, si përfaqësuesi më i lartë i unitetit kombëtar, të gjejë, përmes konsultimeve me të gjitha forcat politike të vendit, një zgjidhje demokratike që të jetë e aftë të sigurojë zgjidhjen e krizës...”

Qeveria italiane dhe bashkësia ndërkombëtare do të respektojnë dhe do të mbështesin vendimet që do të marrë Presidenti i Republikës Shqiptare...”

MOTRA E FATOS NANOS TELEFONON AMBASADËN

E motra e kryeministrit shqiptar, e cila prej disa vitesh jetonte në Romë, fillimisht kishte nguruar në merrte në telefon ambasadën shqiptare, por pastaj ngriti receptorin. Fjalët e saj herë i përngjanin kujës dhe ishin mjaft të kuptueshme, herë dukej sikur visheshin me ngashërim të gjata dhe nuk ishin aspak të qarta. Qante sepse që prej dy orësh

nuk kishte më lajme nga familja e saj dhe nga i vëllai. Nuk lidhej dot në telefon me ta, sepse nuk i përgjigjeshin më. As i ati afro tetëdhjetëvjeçar, as kunata, as motra tjetër, as...

“Mos dini ju se ku gjenden, se unë po shkalloj”, ngashërua ajo. Përgjigja nga punonjësi i ambasadës u mbush me fjalët e pasigurtas: “Kjo gjendje do të dominohet shpejt nga qeveria”.

Ajo ngashërua gjatë dhe vazhdoi t’i përsëriste merakun për jetën e babait plak, të vëllait, të kunatës së saj të mirë, të motrës së dashur... Megjithatë tashmë dukej më e vetëpërmabajtur. Ai e përfytyronte ato çaste në apartamentin e saj të ngushtë në një lagje në jug të Romës, të rrëzuar në shtrat dhe me fytyrë të enjtur nga lotët, tek në njërin dorë mbante dorëzën e telefonit dhe në tjetrën shtrëngonte një fëmijë-kukull, i cili cdo mbërmeje i zinte njërin skaj të jastëkut.

15 SHTATOR, SËRISH SHTYPI ITALIAN

“Në “Corriere della Sera” analisti i njohur Serxho Romano ngulte këmbë që partitë politike italiane nuk duhet të bëjnë disa gabime me Shqipërinë. Më së pari të mos bëjnë në këtë vend një parti më të mirë se tjetrën apo një më të keqe se rivalja e saj. Së dyti, shteti italian duhet të mbështesë atë që aktualisht qeveris. Sipas tij, “bëri shumë mirë që mbështeti atëherë Sali Berishën për hir të stabilitetit dhe bën mirë tani të mbrojë qeverinë e Fatos Nanos”.

Në “La Stampa” shkruhej se në komisionin e Jashtëm të Parlamentit senatori Xhulio Andreotti pati kritikuar ministrin e Jashtëm Lamberto Dini, duke ftuar drejt për drejt shërbimet e fshehta italiane që të hotonin trafikun e armëve midis Kosovës dhe Shqipërisë për të verifikuar lidhjet e mundshme me vrasjen e Azem Hajdarit. Dini dha përgjigje të menjëhershme, duke dashur të përgjeshnjetrojë çdo hipotezë lidhjeje midis

krizës shqiptare dhe luftës në Kosovë: “Ngjarjet në Tiranë janë frut i luftës së brendshme. As Berisha dhe as Fatos Nano nuk kanë interes për të nxitur përlëshjet në Kosovë”.

Në “La Repubblica” atë 15 shtator 1998 botohej edhe një intervistë e nënkryeministrit shqiptar Kastriot Islami me titullin “Tani Berisha duhet të iki, është një kriminel, do ta arrestojmë”.

Midis të tjerash Islami deklaronte se “Sali Berisha nuk është më një bashkëbisedues politik, është një kriminel i kërkuar nga policia dhe rrezikon dënimin me vdekje, sepse është ai që ka përgatitur prej muajsh grushtin e shtetit dhe sulmin ndaj institucioneve”. Më pas shtonte: “Nuk bëhet fjalë për një revoltë popullore. Ishte një grusht shteti i vërtetë. Mes tremjesh vetëve që morën pjesë në funeral kishte edhe treqind njerëz të armatosur me kallashnikovë dhe me dinamit në xhepa”. Nënkryeministri shqiptar po ashtu deklaronte për opinionin publik italian se “Ne nuk shpikim asgjë: ka të dhëna të sakta, edhe prej shërbimit të fshehtë italian me të cilin punojmë në kontakt të ngushtë, sipas të cilit grushti i shtetit ka qenë përgatitur deri në hollësitë më të vogla që prej tre muajsh. Kanë lëvizur persona, janë mbledhur mitraloza dhe eksplozivë... E gjithë kjo ka një emër: grusht shteti. Është ish-presidenti Sali Berisha përgjegjësi kryesor dhe i drejtpërdrejtë. Ligji parashikon edhe dënimin me vdekje për krime si ky. Berisha e di: ose të shkojë ose rrezikon ekzekutimin”.

Ndërkaq “Il Giornale” botonte një intervistë me ish-presidentin shqiptar dhe titulli i saj mbante fjalët “Berisha: Nano është një vrasës”. Duke iu përgjigjur nëntëmbëdhjetë pyetjeve ai rreshtonte argumentet e tij: “Të shtënati i filluan njerëzit e qeverisë...Fatos Nano nuk gjendet, sepse po mobilizon njerëzit e tij për luftë civile, kjo që po ndodh është skenar i tij. Dje nëpërmjet zëvendësimit të tij i vodhi gazetës “Albania” linjën “Internet” dhe transmetoi lajmin se unë do të vritesha. Për të provokuar luftën civile... Kam vetëm një kërkesë: Fatos Nano të japë dorëheqjen...jam për një qeveri teknike...Fatos Nano duhet të iki, unë e njoh mirë, ai është një vrasës...Në rast se Nano nuk dorëhiqet situata do të jetë jashtë kontrollit. Unë nuk bëj gjë tjetër veç u them njerëzve të mos bëjnë dhunë, por ata nuk më dëgjojnë...Nuk është halli që të vijë Sali Berisha në pushtet, por të vendoset rendi publik, institucionet, rregullat, ligjet...”

DUKE U GDHIRË E MËRKURË, 16 SHTATOR

Këtë ditë kryeministri Fatos Nano mbushte 46 vjeç.



"17 nga 21 shkolla në Bashkinë e Urës Vajgurore janë rehabilituar. Investimet do vijnë"

Blendi Klosi inauguron shkollën e rikonstruktuar në Syzez

Ministri shpërndan tekste falas për filloren

Voltiza Duro

Shkolla e njësiesë administrative Syzez në Bashkinë e Urës Vajgurore është gati të presë nxënësit me ambiente të reja dhe me një palestër të re. I pranishëm në ceremoninë e inaugurimit ishte ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi, njëherësh edhe drejtues i qarkut Berat, i cili theksoi se ky vit shkollor i gjen nxënësit me shkolla më të mira dhe libra falas. "Kjo është një dhuratë që qeveria shqiptare, kryeministri Edi Rama ka menduar për të gjithë fëmijët e Shqipërisë, nga klasa e 1 deri në klasën e 4 duke filluar mbajtjen e premtimit tonë elektoral që brenda këtij mandati deri në vitin 2021 vit pas viti të gjithë nxënësit deri në klasën e nëntë të marrin librat falas. Ne do ta mbajmë këtë premtim, sepse mendojmë për njerëzit, kemi vëmendjen të njerëzimit, kemi shumë vëmendje sidomos për ato familje që e kanë të vështirë të mbulojnë këto shpenzime", tha Klosi. Ndërkohë, reformat e ndërmarra për reduktimin e shpenzimeve dhe rritjen e investimeve po ndryshojnë



jetesën e komunitetit. Ministri Klosi vlerësoi punën e bashkisë ku investimet e bëra kanë përmirësuar shërbimin ndaj komunitetit jo vetëm në shkollë, por edhe në kopshte dhe qendra shëndetësore. Min-

istri Klosi tha se investimet dhe reformat në arsim do të vijnë. "Bashkia e Urës Vajgurore mund të jetë nga bashkitë e pakta në Shqipëri në mos bashkia e parë, e cila mundi që brenda një harku kohor të

SYNIMI
"Kjo është një dhuratë që qeveria shqiptare, kryeministri Edi Rama ka menduar për të gjithë fëmijët e Shqipërisë, nga klasa e 1 deri në klasën e 4 duke filluar mbajtjen e premtimit tonë elektoral që brenda këtij mandati deri në vitin 2021 vit pas viti të gjithë nxënësit deri në klasën e nëntë të marrin librat falas", - tha Klosi.

janë bërë të reja, ose kanë marrë rikonstruktion, ose janë bërë shkolla me laboratore të reja ose janë në valën e ndryshimeve. Prandaj viti i ri shkollor na gjen me përkujdesje shumë më të madhe, për nxënësit, për të rinjtë për ata që duhet të marrin dijet dhe përgatitjen për gjithë jetën e tyre", u shpreh ministri duke shtuar se në këtë bashki tashmë ka një sistem të ringritur edhe të kopshteve. Në shkollën e Njësies Administrative Syzez do të ulen këtë vit 433 nxënës nga disa fshatra, të cilët këtë vit për herë të parë do të kenë jo vetëm libra falas deri në klasën e 4-t, por edhe kushte shumë më të mira për të mësuar në shkollë falë rikonstrukcionit, laboratorëve dhe palestrës së re.



Mbi 47 mijë fëmijë, bonus për të mos braktisur shkollën

Mbi 47 mijë fëmijë të familjeve në nevojë përfitojnë nga bonusi për mosbraktisjen e shkollës. Lajmin e ka bërë të ditur ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu, e cila shpërndau librat falas për fëmijët e komunitetit rom në banesat sociale Lanabregas. "Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale po mbështet financiarisht fëmijët e familjeve që përfitojnë nga pagesa e ndihmës ekonomike, që të mos braktisin shkollën. Mbi 47 mijë fëmijë të familjeve në nevojë, përfitojnë nga kjo politikë nxitëse për arsimimin e fëmijëve, pagesa të posaçme për ndjekjen e arsimit të detyrueshëm", tha Manastirliu. 171 milionë lekë është fondi i vënë në dispozicion për vitin 2018 për familjet që janë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike për fëmijët që nuk braktisin shkollën.



maiora premunt / gjëra të mëdha na presin

TRANSFEROHU NË UET

MUNDËSIA E DYTË PËR NJË EDUKIM CILËSOR

DATA 03-13 Shtator 2018

- Juridik i Përgjithshëm
- Financë & Bankë
- Menaxhim Biznesi
- Informatikë Ekonomike
- Shkenca Politike
- Marrëdhënie Ndërkombëtare
- Psikologji
- Sociologji – Antropologji Sociale
- Komunikim – Marrëdhënie Publike
- Komunikim Dizajn

SËMUNDJET E SYVE, JA SI MUND TE TRAJTOHEN

SUMMER

pages

SUPLEMENT I GAZETIA SHQIPTARE

E enjte 13 Shtator 2018



Era nominohet në Brazil për çmimin e rëndësishëm



E akuzuan për skenat hot, reagon për herë të parë Linda Halimi

BULEVARDI POLITIK




- Balla bëhet nostalgjik, takon 'veteranët' që dikur bënin ligjin në PS
- Dhurimi i gjakut, ja VIP-at që iu bashkuan nismës së Metës
- Ruçi u vendos kamera deputetëve, rebelohen socialistët: S'jemi në 'Big Brother'
- Zyrtari i LSI: Pas ca vitesh, ju tregoj kush do jenë burra shteti



E BUKURA DHE MORALI

**Greg Rama, me një "traktat" për artin:
Ata që gjejnë shpjegime të shëmtuara
për gjërat e bukura janë të korruptuar**

Një ushtri shigjetash, që lënë të ndrijë e bardha në FAB



E BUKURA DHE MORALI

Greg Rama, me një "traktat" për artin: Ata që gjejnë shpjegime të shëmtuara për gjërat e bukura janë të korruptuar

Fatmira Nikolli

Një ushtri shigjetash kalojnë tri ambiente. Të mbetura pezull në ajër mes tavanit e dyshemesë nga ku buron drita, shigjetat "kalojnë" muret për të mbërritur po pa e prekur një tollumbac të madh, të bardhë, që pothuaj bashkon 'tokën me qiellin'. E bardha e mureve shkrihet me tollumbacen, tavanin e dyshemesë, duke njësuar ambientin me veprën dhe duke kërkuar "Fidem" në këtë ekspozitë të parë. Një ushtri shigjetash që lënë të ndrijë e bardha në FAB.


"Unë po mbaj një fjalë, që besoj se lidhet me punën që kam bërë. Është pak e gjatë, në qoftë se keni durim ta dëgjoni. Artisti është krijues i gjërave të bukura. Të zbulohet arti dhe të fshihet artisti, ky është qëllimi i artit. Kritiku është ai që mund të përkthejë në një tjetër mënyrë apo në një tjetër material përshtypjet që shkaktojnë tek ai gjërat e bukura". Greg Rama ka emocione në ekspozitën e tij të parë personale. Duart i dridhen kur flet para një publiku që ndjek jetën artistike kryeqytetase e më gjerë. Në galerinë FAB ka dhjetëra të pranishëm, nga skena e artit pamor e jo vetëm. Me kërshtërinë për të parë të parën punë serioze të artistit të ri, që vijen në të dytën përballje me publikun, nëse llogarisim si të parën një punë të ekspozuar të Berat tri vite më parë në festivalin multikulturor. Pos të tjerash, kërshtëria shtohet kur ke të bësh me djalin e kryeministrit, çka nuk shmanget e nuk mund as ta ndash birin nga i ati, qoftë edhe për faktin se të dy kanë ndjekur rrugën e artit, duke u bërë tri breza.

Ai ngjan hermetik, por është krenar i artit të tij në mesazhin që jep.



Një ushtri shigjetash, që lënë të ndrijë e bardha në FAB

"Mënyra autobiografike është forma më e lartë e kritikës, por edhe forma më e ulët. Ata që gjejnë shpjegime të shëmtuara për gjërat e bukura janë të korruptuar, pa qenë dot tërheqës për askënd. Ky është një gabim i madh. Ata që gjejnë shpjegime të bukura për gjërat e bukura janë njerëzit e kultivuar. Nga këta njerëz ne nuk duhet të cilëtojmë gjërat e bukura nuk nënkuptojnë gjë tjetër veçse bukurisë, ata janë të përgjedhurit", tha Gregu. Për të nuk ekziston një veprë arti morale apo imorale, sepse një veprë arti është e realizuar mirë ose jo dhe vetëm kaq. "Urrejtja e shekullit tonë për realizmin është tërbimi që ndjen një kanibal kur shikon fytyrën e tij në pasqyrë. Urrejtja e shekullit tonë për realizmin është tërbimi që ndjen një kanibal kur nuk shikon fytyrën e tij në pasqyrë. Jeta morale e një



njeriu përbën zakonisht temën mbi të cilën artisti punon, por me realitetin në art nënkupton përdorimin perfekt e një mjeti jo perfekt", u shpreh Greg Rama. Ai mendon se nuk ka artist që dëshiron të dalë ku të dalë. Për të edhe gjërat e vërteta mund të provohen. "Asnjë artist nuk ka simpati për etikën. Te një artist simpatia për etikën është një mënyrë sjelljeje e pafalshme. Artisti nuk është asnjëherë i brishtë, artisti mund të shprehë gjithçka. Mendimet dhe gjuha janë për artistin mjetet e punës me të cilat ai krijon artin e tij", shqiptoi Greg Rama para të pranishmëve. Shtoi se në pikëpamjen e formës, mënyra e të shprehurit më e drejtëpërdrejtë në të gjitha artet është loja e muzikantit. Ndërsa në pikëpamjen e ndjesisë është ajo e aktorit. "Çdo art është njëkohësisht sipërfaqe dhe simbol. Ata që zhyten poshtë sipër-


Era nominohet në Brazil për çmimin e rëndësishëm

Era Istrefin duket se e duan edhe në Brazil. Këngëtarja këtë herë është nominuar për një çmim shumë të rëndësishëm në atje. Era është në garë për t'u zgjedhur si artistja më e mirë e re nga skena ndërkombëtare, në BreakTudo Awards. Këto çmime ndahen në Brazil për çdo vit, për artistët më të suksesshëm të vitit, ndërsa vetëm nominimi i Erës është një sukses i madh, pasi do të thotë se ajo ka qenë ndër artistet më të dëgjua të vitit në këtë vend. Sukseset për Erën këtë vit siç duket nuk paskan të ndalur.

Era Istrefi competes for the BreakTudo Awards 2018 in the International New Artist category. Polls are unlimited and open until October 15. @BreakTudo #BreakTudoAwards #Eralstrefi @strefie

Vote now: bit.ly/BTDAs2018M

Tweet übersetzen



Luana shkon në zyrë, ja si e quan veten moderatoresha

Kjo verë për moderatoreshën Luana Vjollca ka qenë një ndër më aktivet si me koncertet, klipet ashtu edhe me sezonin e ri televiziv. Mëngjesin e sotëm ajo ka publikuar në rrjetet sociale një foto ku e shohim të veshur mjaft bukur dhe gati për të shkuar në zyrë për sezonin e ri: "Bosi i vogël po shkon në zyrë. Gati për sezonin e ri televiziv," shkruan Luana krahas fotos ku duket më në formë se kurrë. Moderatoresha ende nuk ka zbuluar detaje nga formati i saj, i cili do të jetë sërish në ekranin e "Top Channel".



faqes e bëjnë këtë në rrezikun dhe në dëmin e tyre. Ata që përpigën të deshifrojnë simbole e bëjnë po këtë gjë në dëmin dhe në rrezikun e tyre. Mendimet e ndryshme dhe të shumta që sjell një vepër arti provojnë që kjo vepër është diçka e re, komplekse dhe me rëndësi jetësore", tha Greg Rama në një fjalim, që ngjante si një traktat për artin. Në këtë vazhde shtoi se kur kritikët janë në mosmarrëveshje me njëri-tjetrin, artisti është në mirëkuptim të plotë me veten e tij. "Dikujt mund t'i falet prodhimi i një gjëje pa vlerë, fill në çastin kur ai nuk e adhuron këtë gjë. I vetmi justifikim që mund të përdoret për diçka pa vlerë është që dikush e adhuron këtë gjë me gjithë shpirt. Arti është pa vlerë", e mbyllti ai fjalën e tij.

KURATORI

Për kuratorin Vladimir Myrtezai, ekspozita sjell disa koncepte. "Besim, komunikim i hapur dhe afritet është një trekëndësh, që shënon një territor të personalizuar për artistin e ri Greg Rama, i diplomuar pak vite më parë në Universitetin e Arteve në Tiranë. Si përpara çdo subjekti, në trokitjet e para për t'u identifikuar, autori i kësaj ekspozite shpall sfidën e tij për të dalë përpara publikut, duke na kujtuar kështu ngërçin e madh të hapit të parë që përjeton çdo artist", thotë Myrtezai. Sipas tij, përpos trashëgimisë familjare, ai përballet po aq edhe me nevojën për një stacionim të mendimit dhe aktit krijues, duke u besuar më shumë ndijimeve dhe përvojave personale si condition sine qua non për krijimtari. Besimi i hapur mbi çfarë mund të gjente në korrentet e eksperimentit shoqëruar me një intuitë premtuese që e lidh artistin me



shenjën, tingullin dhe dendësinë e formës me të cilën afrohet, i hapin atij një rrugë të qenësishme ku përfshihet të besojë. Myrtezai veçon se përmes lojës me hapësirën, ai ndërton një ekuilibër mes konceptit dhe trupëzimit të një energjie, që e identifikon duke i hequr gravitetin arkitektonik mediut, duke përdorur po aq edhe një lloj transfigurimi thjeshtëzues drejt trajtave elementare e parake. "Pika, vija, rrafshi, mungesa e gravitetit bashkërendohen për të (ri)lexuar konceptin e një ndërhyrje hapësinoe, jo më si një ngjarje lineare, por me asociime qëndrimesh të aksidentuara e vertikale, duke na afruar atë përvojë që mund ta quajmë vëllim i shformuar ele-



mentesh ose energji e kulluar pastër. Perceptimi është i pakohë dhe larg analizës së zhvendosur në kohë, sepse koha në këtë rast ekziston vetëm si një element i qëruar nga rrethanat tipizuese, duke shfrytëzuar ecejaket e një ndjeshmërie të veçantë, shkruan kuratori i "Fidem". Për të, artisti është i vetëmjaftueshëm në elemente krejt të thjeshtë, por shumë pranë një sinkroni energjish që zhbën narrativën apo rrethanën site-specific, autori krijon veprën dhe gjuhën e saj në të njëjtën kohë. Greg Rama ka një shprehje të "lindur", në afri me fjalën, të shkruarit dhe komunikimit, ndaj dhe shfaqja e tij e parë nën kopolën "Fidem" - "Besim"/"Vërtetësi" përvijon një lëvizje komunikuese nëpërmjet një mediumi, i cili përfshin hapësirën ku ai zhvendos strukturën e tij. Fuqia e interpretimit dhe e asociimit krijon një territor kulturor të ndërmjetëm ku frymon ndjeshmëria e artistit. "Autori e ndjen veten në rrokullimat e shpeshta mohuese, aq domethënëse për një artist në rritje, për të hapur kështu rrugën e tij, që tanimë i duhet ta ndajë edhe me publikun, si një mundësi për të rimenduar dhe riparë sheshpushimet si akte ndikimesh të panjohura apo të rishikuara artistike. Greg Rama vjen si një komunikim i pamundur i gjithë atij monologu të brendshëm e kaotik që së shumti nuk ndahet drejtpërdrejt, por i kamuflluar përmes gjuhës së ndërmjetësuar të artit", thotë Myrtezai. Dalja e tij e parë në publik është pikënisje e këndvështrimit i hapur, që do të mundësojë hapjen e tij të radhës në kurajën e parashikimet e ndërgjegjes së tij si artist në një rrugë të gjatë e të vështirë.

KESHILLA

Problemet më të zakonshme të syve janë infeksionet, që mund të kurohen me higjienë të mirë dhe me antibiotikë me pika.

Infeksionet e syve janë një problem i zakonshëm që mund të prekin secilin njeri, pa marrë parasysh gjininë apo moshën. Infeksionet mund të shkaktohen nga bakteret, viruset, alergjitë, që mund të prekin njërin apo të dy sytë.

Por nga se shkaktohen dhe si mund të trajtohen këto probleme?

INFEKSIONI I QERPIKËVE (BLEFARITIS)

Ky është një infektion i qerpikëve të syrit. Nuk është serioz dhe mund të ndalohet me masa ndihmëse. Flisni me mjekun nëse sytë bëhen ngjites ose nuk pastrohen brenda një jave.

Shenjat: Cepat e syrit janë të kuqe, të infektuara dhe mund të vini re pika qelbi të tharë tek qerpikët.

Trajtimi: Duke përdorur pambuk me ujë të zier me gjysmë luge kripë, pastroni sytë e fëmijës duke nisur nga hunda. Përdorni pambuk të ri sa herë që i pastroni dhe bëjeni këtë çdo mëngjes dhe darkë, derisa të shërohet. Mjeku mund t'ju japë ilaç me pika, nëse ka infektion.

INFEKSIONI I MEMBRANËS QË MBULON KOKËRDHOKËT E SYRIT (KONJUKTIVIT)

Ky infektion mund të vijë nga një virus, nga futja e një trupi të huaj në sy dhe një reaktion alergjik. Është shumë ngjites, kështu që kujdesuni për syrin tjetër nëse nuk është infektuar.


Shenjat: Infeksioni shkakton dhimbje dhe vështirësi për të parë dritat e forta. Kur konjuktivi shkaktohet nga bakteret, mund të ketë qelb në kapakun e poshtëm të syrit. Konjuktivi alergjik shkakton lot dhe qepalla të fryra.

Trajtimi: Pastrojeni mirë syrin me ilaç të përshtatshëm ose me ujë. Duhet të trajtohen të dy sytë, sepse ky infektion është shumë ngjites. Kur ka trup të huaj hiqeni me kujdes. Në rastin e një infeksioni të rëndë, mjeku do t'ju japë antibiotikë apo ilaç me pika.

BYCI
Kur rrenja e qerpikut infektohet, atëherë në sy shfaqet një fryrje e dhimbshme, plot qelb, në anë të qepallës. Fërkimi i



Sëmundjet e syve



syve mund ta keqësojë.

Shenjat: Në fillim qepalla enjitet pak dhe pastaj mbushet me qelb.

Trajtimi: Megjithëse byci nuk është aq ngjites, fëmija duhet të përdorë peshqir të veçantë. Mjeku do t'ju rekomandojë antibiotikë dhe kompresa me ujë

të ngrohtë. SYTË E VËNGËR/ STRABIZMI

Sytë e fëmijës shohin në drejtime të ndryshme, ndonjëherë drejt njëri-tjetrit dhe ndonjëherë në drejtim të kundërt. Deri në tetë javë kjo është normale, por më vonë duhet të flis-

ni me mjekun.

Shenjat: Nëse dyshoni për strabizëm, shikoni sesi reflektohet drita në sytë e fëmijës. Drita duhet të reflektohet nga i njëjti vend në çdo sy, nëse jo, pra nëse sytë janë drejtuar në drejtime të ndryshme, thërrisni mjekun.

Trajtimi: Mbuloni syrin e fortë me një fasho. Kjo do të detyrojë muskujt e syrit të dobët të behen më të fortë. Sytë duhet të drejtohen brenda 5 muajsh, megjithëse mund të duhet edhe më tepër kohë. Për fëmijët që janë mbi 1 vjeç, mjeku mund t'ju këshillojë syze.

Balla bëhet nostalgjik, takon 'veteranët' që dikur bënin ligjin në PS

Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla, takoi dje anëtarë dhe faktorë të rëndësishëm të Partisë Socialiste gjatë viteve 1992-1996. Kështu Balla, ka mbledhur ditën e sotme në një fotografi të postuar në 'Instagram', anëtarë dhe drejtues të Grupit Parlamentar të PS-së së asaj kohe. Dallojnë në foto socialistët e vjetër si Et'hem Ruka, Servet Pëllumbi e Namik Dokle, por edhe anëtarë të vjetër që vazhdojnë të jenë pjesë e grupit dhe skenës politike si kryeparlamentari Gramoz Ruçi, deputeti Anastas Angjeli, ministri i Diasporës Pandeli Majko e deputeti Musa Ulqini. Shumë prej tyre janë figura që kanë shënuar në historinë e parlamentit dhe krijimin e demokracisë në Shqipëri.



Dhurimi i gjakut, ja VIP-at që iu bashkuan nismës së Metës

Nismës së Presidentit të Republikës për dhurimin e gjakut i janë bashkuar së fundmi edhe njerëz të skenës, sportit apo gazetarisë. Gjatë ditës së djeshme kontribuuan vullnetarisht në prani presidentit për të dhuruar gjak dhe për t'i ardhur në ndihmë atyre që kanë nevojë për të, kryesisht të prekurit nga talasemia. Mes tyre bien në sy këngëtarët Aurela Gaçe dhe Sidrit Bejleri, aktori Bes Kallaku, si edhe misi i parë shqiptar, Valbona Selimllari.



"Kam një falënderim të veçantë për këtë grup të mrekullueshëm artistësh, sportistë e gazetarë të mirënjohur, që iu bashkuan me vullnetarizëm kauzës jashtëzakonisht humane të dhurimit të gjakut. Me aktin e tyre, për t'iu bashkuar "Aleancës së dhurimit të gjakut", ata treguan edhe sot se përfaqësojnë denjësisht vlerat tona më të mira kombëtare, humanizmin dhe solidaritetin. Në shembullin e tyre i ftoj edhe njëherë të rinjtë e të rejtat, të bëhen dhurues të rregullt të gjakut, përmes një procesi tërësisht të sigurtë, që iu shërben jo vetëm shëndetit të tyre, por edhe ndihmon për të shpëtuar jetën e njerëzve që kanë aq shumë nevojë për të", -shprehet Meta.



BULEVARDI POLITIK

Në merrni seriozisht! 😊



Ruçi u vendos kamera deputetëve, rebelohen socialistët: S'jemi në 'Big Brother'

Sesioni i ri parlamentar i ka gjetur sallat ku zhvillohen mbledhjet e komisioneve me një pamje të re, ku përveç ljerjes është instaluar dhe vënë në funksionim sistemi i ri elektronik i kamerave dhe mikrofonave. Por, kjo duket se ka sjellë shqetësimin e deputetëve, të cilët ndihen nën presionin e përgjimit '24 orë në 24'. Gjurma.al shkruan se deputeti Ilir Beqaj e krahasoi funksionimi e tyre me një 'Big Brother' çka sjell transmetimin në zyrat qendrore edhe të bisedave, që nuk janë në funksion të punës së Kuvendit. I shqetësuar dukej edhe deputeti Robert Bitri, i cili kërkoi fikjen e kamerës së TV SCAN në momentin që kjo çështje po diskutohej mes anëtarëve të komisionit. Insistimi i tij u ndal vetëm pas ndërhyrjes së kreut të Komisionit të Veprimtarive Prodhuese, Shalë, i cili kërkoi regjistrimin e diskutimit.



Zyrtari i LSI: Pas ca vitesh, ju tregoj kush do jenë burra shteti

Flamur Çelaj, Kryetari Komisionit të Sigurisë Kombëtare nga Lëvizja Socialiste për Integritet, ish-deputet i Vlorës, publikon këtë foto me djem të rinj nga gjaku i tij për të cilët thotë se pas ca vitesh, ata do të jenë burra shteti, biznesi ose vip-a futbollit. "Pas ca vitesh kur të dal në pension, me dëshirë. Të gjithë këta çunat e rinj në foto, do jenë burra shteti, biznesi ose vip-a futbollit! Po e hedh këtë foto tani që janë filiza të rinj e tua tregoj nesër kur të jenë bërë të lartë dhe hijerëndë. Çfarë do që të bëheni në jetë, djem mbani miqësinë dhe bota do të jetë e juaja", -përmbyll Çelaj.



Trashëgimtarët duhet të plotësojnë dokumentet në Drejtorinë e Pagesave

Ornela Manjani

Rreth 250 trashëgimtarë të ish-të dënuarve politikë që presin të marrin kështin e dytë duhet të plotësojnë dokumentacionin që u mungon në dosje për të marrë më pas paratë. Lista është bërë publike nga Ministria e Financave, e cila u ka lënë përfituesve tre muaj kohë për të plotësuar dosjen. Bëhet fjalë për përfitues të kategorisë jo parësore që do të trajtohen me dëmshpërbim, por që sipas këtij dikasteri duhet të dorëzojnë dokumentet. Ministria e Financave u kërkon përfituesve të kështit të dytë të dorëzojnë në drejtorinë e pagesave numrin e llogarisë për të marrë dëmshpërbimin.

DOKUMENTET

Të gjithë trashëgimtarët

Ish-të përndjekurit, 250 përfituesit e kështit të dytë

Afati për plotësimin e dosjes, 3 muaj

e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shuma e dëmshpërblimit kthehet mbrapsht në buxhet duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, Emër/Mbiemër, apo

në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një gërmë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoemos që në të gjitha dokumentet emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në certifikatën

e lëshuar nga gjendja civile. Në rast se ka transkriptime të gabuara gjat kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon edhe rastet e

ekzekutimeve pa gjyq. "Në rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq, është i domosdoshëm një vendim fakti gjykatë që vërteton vdekjen, plus një certifikatë negative të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzistojnë dokumente të periudhës përkatëse dhe ky

fakt vërtetohet nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative", thuhet në njoftimin që Ministria e Financave bën për të sqaruar trashëgimtarët e ish-të dënuarve që nuk kanë marrë ende dëmshpërbimin.

PËRFITUESIT E KËSTIT TË DYTË

TELET SERVET PESHKEPIA
ANGJELINA SKENDER
KEMBACI
JOLANDA SKENDER ZEFI
TEREZINA SKENDER MESHAJ
LILJANA KOLE BECANI
MAJLINDA KOLE POPOVIC
EMA KOLE MATANOVIQ
BAFTIJE SELMAN RUSI
HAJRIJE SELMAN KAZANI
RYZHDIJE JAKUP MUZHAQI
HAZIZ JAKUP QYTYKU
XHEMILE JAKUP POCI
IBRAHIM MATJANI
LAHE MATJANI
HAJDAR IBRAHIM MATJANI
AHMET IBRAHIM MATJANI
DASHURI IBRAHIM DERVISHI
ZYLFE IBRAHIM NEZHA
PRANVERA MUHAREM DURMO
ISLAM MUHAREM NEZHA
ILIR MUHAREM NEZHA
MARGARITA MORCKA
AURORA VANGJEL LEKA
FEDERIK LUIGJ COKU
YZEDIN PETREF RESULI
ASIJE PETREF RESULI
MRIKE KROS GJIKOLAJ
VJOLLCA GORI REXHEPAJ
LEONORA GORI NATI
GRAMOS FASLLI LLAPERI
SULLTANE QAZIM LLAPERI
MARIJE NDREK LEKAJ
DILE NDREK GJONI
LULE NDREK NDOJ
PASHKO ZEF NDOJ
GJELINA ZEF KITANOSKA
MARJANA ZEF OGNENOSKA
ALEKS ZEF NDOJ
ANDREA ZEF NDOJ
SADETE TAIP SUKNI
KATIA TEUFIK SUKNEJ
GENC TEUFIK SUKNI
SOKOL TEUFIK SUKNI
MIRE NDUE TOPLANA
GEZIM NDUE RRIFA
NIKE NDUE RRIFA

DILE NDUE RRIFA
GJERGJ NDUE RRIFA
KATRINE LULASH KOKAJ
GJYLJANA MIRASH
ULDEDAJ
GAPER NIKOLL ULDEDAJ
GJELINE NIKOLL GJINAJ
LODOVIK NIKOLL ULDEDAJ
MANDALENA NIKOLL
PEPA
ROZE NIKOLL QOSE
FLORA NIKOLL VULAJ
VERA NIKOLL MALOCAJ
ZEF MIRASH KOKAJ
VITORE ZEF BZHETAJ
MIRASH ZEF KOKAJ
DODE ZEF KOKAJ
TEREZE ZEF VULAJ
LULASH ZEF KOKAJ
NIKE ZEF KOKAJ
GJOK MIRASH KOKAJ
PRENA DODAJ
SIMON PRENG DODAJ
EDUART SIMON DODAJ
VIOLETA SIMON ARAPI
AGE SIMON LLESHAJ
VITORE SIMON GJETA
TINE SIMON GJETA
MARJANA SIMON DODAJ
AGUSTIN SIMON DODAJ
ARBEN SIMON DODAJ
ANTON SIMON DODAJ
FRROK PRENG DODAJ
MANTHA NIKO ÇARO
ODHISEA PANO ÇARO
ANTHULLA PANO ÇARO
FANE PANO ÇARO
VITORI PANO AHMETAJ
PRENDE MARK BUSHI
BARDHOK DEDE BUSHI
PRENG DEDE BUSHI
TEREZINA DEDE TUSHA
ZEF PASHK PALAJ
KRISTINA ZEF PIROLI
MARK ZEF PALAJ
VINCENS ZEF PALAJ
PASHK ZEF PALAJ (ZEFI)

VOJSAVA ZEF MARKU
ANTONETA ZEF PALAJ
GJON ZEF PALAJ
ADNAN SABRI NASUFI
ZINETE SABRI LAZIMI
FITIM BASRI LAZIMI
LEJLA BASRI ZUNA
MIMOZA BASRI NDRECI
MYZEJEN SABRI SHEHU
FERIZAT SABRI TOSKA
SETKIJE ESAT GJONI
FEMI ESAT TOSKA
SHPETIM ESAT TOSKA
NEXHMIJE ESAT TOSKA
DIHANE SABRI TREPCA
QEMAL SABRI NASUFI
ARSEN QEMAL NASUFI
EUGEN QEMAL NASUFI
EDLIRA QEMAL NASUFI
BASHKIM SABRI NASUFI
HAMIDE MEHMET KETA
BASHKIM JONUS KETA
JONUZ JONUS KETA
NURIJE SAID KERÇIKU
SHEFIKAT KASEM TUJANI
SHKELQIM KASEM KERÇIKU
ARTAN KASEM KERÇIKU
ELISA KASEM MUHO
EMINE SEIT(SAID) FUSHA
MUHARREM SELIM HOXHA
FADIL MUHARREM HOXHA
BASHKIM MUHARREM HOXHA
FLORA MUHARREM KUCI
SAMI MUHARREM HOXHA
ILMI MUHARREM HOXHA
BUKURIE MUHARREM OSMAJ
AHMET SELIM HOXHA
ZOJE AHMET DOLLAPAJ
RAMADAN AHMET HOXHA
BASRI AHMET HOXHA
BEDRI AHMET MULAJ
FERIZ AHMET HOXHA
MIMOZA AHMET MEMIA
NAIM AHMET HOXHA
ZEF HAJDAR PROGNI
ZOJE ZEF GJELOSHAJ
MARTIN ZEF PROGNI

GEGE MARTIN PROGNI
LULE MARTIN GJONPALAJ
AGIM (VAT) MARTIN PROGNI
MERITA MARTIN BREGU
KUJTIM MARTIN PROGNI
FILE MARTIN PISHA
LULASH ZEF PROGNI
DUKATE LULASH RRETHI
SELVIE LULASH PROGNI
MIRASH ZEF PROGNI
NDUE MIRASH PROGNI
PELLUMB MIRASH PROGNI
KOLE MIRASH PROGNI
JETA NDUE PROGNI
TOMOR SABRI ZANI
BEDRI SABRI ZANI
DRITA SABRI BENGU
SHKENDI SABRI HAZIZI
MLTIADH SABRI ZANI
CLIRIM SABRI ZANI
MUHAMET SABRI ZANI
BARJAM SABRI ZANI
SELVIE BAJRAM CEKREZI
VALENTINA BAJRAM TAFI
VENETIKE BAJRAM TAFI
ENGJELL BAJRAM ZANI
VASILIKA BAJRAM SANI
MITAT BAJRAM ZANI
DASHNOR BAJRAM ZANI
KIMETE BAJRAM ZANI
Myslim Bektash Conga
Dare Bektash Conga
Hajdar Bektash Conga
Esat Hajdar Conga
Bektash Hajdar Conga
Qerime Hajdar Rroshi
Naferite Hajdar Hoxha
Anife Hajdar Musaj
Sheqere Hajdar Rroshi
Misire Hajdar Zaimi
Dile Bektash Conga
Nafije Sul(Sulejman) Noga
Ilir Riza Noga
Lete Sul(Sulejman) Lleshi
Liljana Qamil Valteri
Vere Qamil Valteri
Nihat Sul(Sulejman) Kurti

Behixhe Sul(Sulejman) Kola
Besnik Sul(Sulejman) Kurti
Almira Besnik Kurti
Ylber Shefki Valteri
Kico Mitro Foti
Milo(Mihal) Mitro Foti
Mahe Mitro Qendro
Arikli Jorgo Qendro
Natasha Jorgo Qendro
Florika Jorgo Qendro
Persefoni Jorgo Qendro
Suzana Jorgo Qendro
Anesti Jorgo Qendro
Teuta Jorgo Qendro
Aleksander Jorgo Qendro
Illo Mitro Foti
Kujtim Illo Foti
Maksim Illo Foti
Vladimir Illo Foti
Liman Arif Suci
Avni Liman Suci
Fetie Liman Vokri
Arif Liman Suci
Myrvete Liman Suci
Hysen Arif Suci
Skender Hysen Suci
Lirije Hysen Suci
Sami Hysen Suci
Shpetim Hysen Suci
Zenele Hysen Suci
Lule Hysen Ahmetaliaj
Drita Hysen Gjoka
Miranda Hysen Suci
Vera Arif Skonja
Hazis Arif Suci
Sirri Tahir Beshiri
Ilmije Tahir Hamzaraj
Lutfie Tahir Dizdari
Alkion Suljeman Dizdari
Anil Suljeman Dizdari
Esat Tahir Beshiri
Patricja Esat Beshiri
Cristina Esat Beshiri
Daniele Esat Beshiri
DYLBIJE MESTAN BILELLI
YLBER MESTAN GANO
RAMAZAN MESTAN GANO

Kreu kosovar, "pro" referendimit: NATO nënkupton stabilitet për mbarë rajonin

Ditën e djeshme, presidenti Hashim Thaçi ka vizituar Shkupin, ku është takuar me kryeministrin e Maqedonisë Zoran Zaev. Në fjalën e tij, Thaçi ka theksuar se marrëveshja me Aleksandër Vuçiqin nuk e cenon Maqedoninë. "Nuk do të bëjmë asnjë marrëveshje që cenon miqtë tanë as Maqedonisë, as Shqipërinë as Malin e Zi dhe asnjë vend tjetër, por do të jetë një marrëveshje e koordinuar në plotësi me BE-në me SHBA dhe miqtë e partnerët tanë", ka thënë Thaçi. Ndërkohë, Zaev deklaroi se: "Maqedonia përsërit dialogun mes Kosovës dhe Serbisë. Maqedonia mbështet zgjidhjen që do të përfortoq pagën dhe stabilitetin në rajon. Është e rëndësishme që liderët e rajonit të bashkohen në rrugën drejtë integritimit euro-atlantik". Thaçi po ashtu nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit mes dy vendeve. "Kosova dhe Maqedonia nuk kanë asnjë çështje të hapur, janë dy shtete mike me një bashkëpunim të shkëlqyer", deklaroi Hashim Thaçi. Ai theksoi rëndësinë e bashkëpunimit mes dy vendeve, duke theksuar edhe ndërtimin e autostradës, e cila do të mundësojë qarkullimin e njerëzve dhe mallrave dhe do të ndikojë në rritjen e bashkëpunimit ekonomik. "Kosova dhe Maqedonia nuk kanë asnjë çështje të hapur, janë dy shtete mike me një bashkëpunim të shkëlqyer", deklaroi Hashim Thaçi, presidenti i Kosovës, i cili njëherit përsëriti edhe arrijtjen e marrëveshjes mes Maqedonisë dhe Greqisë. Thaçi ftoi qytetarët e Maqedonisë që të votojnë "pro" referendimit, sepse sipas tij Maqedonia në NATO nënkupton stabilitet për mbarë rajonin. Ndërkaq lidhur me referendumin e 30 shtatorit, partitë politike në Maqedoni, edhe pse të ndara për një sërë çështjesh,

Thaçi: Marrëveshja me Vuçiqin s'e cenon Maqedoninë

Zaev: S'kemi çështje të hapura me Kosovën



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi me kryeministrin maqedonas, Zoran Zaev

bashkohen në një pikë. Ato njëzëri shprehen se mbështetjen referendumin për zgjidhjen e çështjes së emrit me Greqinë, ndërsa bëjnë thirrje që qytetarët të dalin në votime. BDI-ja, Aleanca dhe Besa janë në një linjë në këtë drejtim, pasi sipas tyre, referendumi i hap rrugë vendit në anëtarësimin e strukturave euro-atlantike. Përfaqësues të këtyre partive kanë folur për mediat në Maqedoni, ku pikëpamjet e tyre janë në të njëjtën korriç. "Këtu kemi njerëz, të cilët kanë qenë në qeverisjen e kaluar dhe çuditërisht iu bashkëngjiten kësaj shumice me po të njëjtën retorikë, po i bëjnë konfuz edhe njerëzit pasi nuk dinë

më se cilës retorikë t'i besojnë. Kjo që po e them është e hapur, se ne nuk duam që të jemi pjesë lojërave të partive politike që duan këtë çështje të integrimin në NATO ta personalizojnë apo t'i marrin meritat për vetë", deklaroi Arianit Hoxha nga Lëvizja BESA e Kasamit. "Një ndër shtyllat, nga tre shtyllat kryesore të BDI-së është integrimi i vendit në NATO dhe Bashkimin Evropian. Ne japim përgjegjësi për pjesën tonë të bashkëqeverisjes në të kaluarën. Por ne jemi dëshmitarë se pa Bashkimin Demokratik për Integrim nuk do të ndodheshin ndërrimet që u bënë pas 27 prillit", theksoi Rexhail Ismaili, deputet i BDI-së.



KE i kërkon Parlamentit European t'i heqë vizat Kosovës

Duke qenë se çështja e liberalizimit të vizave të Kosovës ka kaluar në Komitetin për Liritë Civile, Drejtësi dhe Çështje të Brendshme (LIBE), tani është hapur rruga për fillimin e

KOMISIONI EUROPIAN

"Kosova ka bërë përparim të madh gjatë dy vjetëve të fundit dhe është e rëndësishme që zbatimi i të gjitha standardeve të vazhdojë. Komisioni tani inkurajon Parlamentin Europian dhe Këshillin për të ecur përpara në propozimin e Komisionit për heqjen e kërkesave për vizat për Kosovën", - thuhet në përgjigjen e Komisionit. "Kosova ka bërë përparim të madh gjatë dy vjetëve të fundit dhe është e rëndësishme që zbatimi i të gjitha standardeve të vazhdojë. Komisioni tani inkurajon Parlamentin Europian dhe Këshillin për të ecur përpara në propozimin e Komisionit për heqjen e kërkesave për vizat për Kosovën", thuhet në përgjigjen e Komisionit dhënë "Zërit".

SHKURT



Franca nderon shqiptarin "hero"

Udesh të bënte një akt heroik që të përfitonte statusin e azilantit. Florim Shehu, 33-vjeçari kosovar që rrezikoi jetën për të shpëtuar 6 pjesëtarë të dy familjeve franceze të bllokua nga përmbytjet, është shpërblyer nga krerët e komunës Shonzhë në veriperëndim të Francës. Autoritetet i dhanë atij shtetësinë franceze, të cilën e ëndërronte prej shtatorit të vitit 2017, kur mbërriti në Francë pasi ishte larguar nga Kosova për një jetë më të mirë në perëndim. 3 muaj më parë Florim Shehu hyri në shtëpitë e fqinjëve të tij, duke u ardhur në ndihmë për t'i nxjerrë prej andej, pasi shtëpitë u ishin përmbytur nga fryrja e lumit që kalonte pranë shtëpisë së tyre. Mediat franceze shkruajnë se ai nuk mori parasysh asgjë dhe kreu aktin human, që edhe vetë ekipet franceze të emergjencës e kishin të vështirë ta bënin. 33-vjeçari është i martuar dhe ka dy fëmijë. Gjesti i tij është krahasuar me atë të azilkërkuetit afrikan që hipi 4 kate duke u kacavjerrë në fasadën e një pallati për të shpëtuar një fëmijë që rrezikonte të binte nga ballkoni. Gjesti u vlerësua me medalje nga presidenti francez Emanuel Makron.

Shkon në 99 numri i viktimave nga zjarri në Mati, vdes 26-vjeçarja

Është rritur bilanci i viktimave nga zjarri në Mati në Greqi. Mediat greke shkruajnë se ka humbur jetën edhe një 26-vjeçare që kurohej në spitalin Evangjelismo prej një muaji e gjysmë. E reja nuk ka mundur të mbijetojë për shkak të plagëve të marra. Me vdekjen e saj numri i viktimave shkon në 99. Zjarri masiv që përfshiu Greqinë shkaktoi jo vetëm viktima, por edhe dëme materiale. Mes viktimave ishin dhe 11 fëmijë, ku më i vogli ishte një foshnjë 6-muajshe.

Juncker: BE do të dërgojë 10.000 roje shtesë në kufij

Presidenti i KE: Të gjejmë unitetin, Ballkani Perëndimor rrezikon influencën nga të tjerë

BE ka në plan të dërgojë 10.000 më shumë roje kufitare për të luftuar imigracionin e paligjshëm deri në vitin 2020, ka thënë presidenti i Komisionit Europian Jean-Claude Juncker në deklaratën e tij vjetore. Ai bëri thirrje për më shumë solidaritet, sesa për "zgjidhje ad-hoc", për njerëzit në anijet e emigrantëve. Fjalimi i tij, gjithashtu, trajtoi çështjet e tjera të rëndësishme të rajonit, populizimit, terrorizmit dhe Brexitit. Këto janë 12 muajt e fundit të Juncker në rolin e tij. Ai, gjithashtu, propozoi një aleancë të re Afrikanë-Evropiane, bazuar në bashkëpunim dhe jo në bamirësi duke

çuar në një marrëveshje të tregtisë së lirë mes kontinenteve. Ai rekomandoi që euro të përdoret më strategjikisht si monedha më e madhe pas dollarit. Dhe ai bëri thirrje për udhëheqje të fortë në Brexit. "Mbretëria e Bashkuar nuk do të jetë kurrë një vend i tretë i zakonshëm për ne", tha ai. "Ne nuk do të militarizojmë Bashkimin Europian. Ajo që duam është që të bëhemi më autonom dhe të jetojmë në përgjegjësi tona globale", tha ai. "Vetëm një Europë e fortë dhe e bashkuar mund të mbrojë qytetarët tanë nga kërcënimet e brendshme dhe të jashtme,



Presidenti i KE, Jean Claude Juncker

nga terrorizmi të ndryshmet klimatike". Kreu i KE u kërkoi shteteve anëtare të Bashimit Europian të gjejnë gjuhën e përbashkët për ta bërë Ballkanin Perëndimor, pjesë të unionit. "Euro-

pa mund të eksportojë stabilitet, siç kemi bërë me zgjerimet e njëpasnjëshme të unionit. Për mua, ato janë dhe do të mbeten histori sukseesi. Por ka ende shumë për të bërë. Duhet të gjejmë një

herë e mirë unitetin kur vjen fjala për Ballkanin Perëndimor. Nëse jo, fqinjët tanë më të afërt do të drejtohen në të tjerët", - thotë Juncker. Gjatë një debati me Presidentin Makron në muajin prill, Juncker paralajmëroi se zbehja e influencës evropiane në Ballkanin Perëndimor rrezikon ta kthejë rajonin në konfliktet e përgjakshme të viteve 90. Po ashtu edhe zyrtarët të tjerë të Bashimit Europian e kanë shprehur haptazi rrezikun e rikthimit të influencës urre. Disa vende anëtare janë kundër anëtarësimit të shpejtë të unionit pasi i druhen rritjes së mbështetjes për grupimet euroskeptike.

Opinion i Ditës

Dea flet me gjuhën e imazhit. . . .

Nga Përparim Kabo

... qytetin e 40 shenjtoreve në Sarandë, në një kinema në qiell të hapur, do të zhvillohej një festival ndërkombëtar filmi me emrin "Dea". Në fakt, diku më herët, në vitin e largët 1925, një tjetër udhëtar i interesuar, piktori francez Lui Dupre vizitoi Butrintin dhe më tej shkroi: "Një ditë eksplorimi i rrënojave do të nxjerrë në dritë një pasuri të madhe zbulimesh, të cilat janë mbuluar gjatë gjithë këtyre shekujve nga mjegulla e natës". Po mbushen gati 200 vite dhe ky zë nuk është dëgjuar plotësisht. Raportet me Trojën dhe me Romën e lashtë si studime të thelluara ende kanë mbetur shumë të zbehta. Ato që lidhen me Trojën përmbledhen vetëm në çka shkruar Virgjili dhe janë të shprehura me argumentin dhe gjuhën e legjendës. Kush ka frikë nga kjo përmbysje në fushën e shkencës historike? Mbasa janë shumë, këtë e andej kufirit. Unë jam me bindjen se heshitja një ditë do të kthehet në zë, memecleku do ia lërë vendin gjuhës që flet. Koka e Deas qëndron atje në krye të ansambli të Butrintit, si riprodhim pranë me topin e mesjetës dhe ndërhyrjet nga Ali Pasha... Elementet e antikitetit dhe ato Veneciane të mbetura disi në hije. Koka origjinale e Deas erdhi në 1981 nga arratisja apo rrëmbimi i parë, por pa trupin.

Kishte ndodhur që edhe kur u krijua trupi ishte me material vendor, ndërsa koka me flokët e krehur dhe me dredha flisnin për një stil helen, aq sa linin të mendohej se si edhe ndodhte rëndom aso kohe koka, të ishte ndërtuar në Heladën e asaj periudhe. Studiuat mendojnë "se ato koka të rralla të stilit të Praksiletit ishin aq shumë të famshme gjatë shekullit IV". Dea pra, qenka edhe si statujë një fatkeqe e gjymtuar. Trupi më vete humbur pa nam e pa nishan dhe koka në një tjetër vend, në atdhe. Dëshmi për të gjenden edhe në botimin në revistën franceze "Gazette des Beaux-Art", vëll.V, 1931. Salomon Reinach (1858-1932), arkeologu i shquar francez shprehet për pasuritë arkeologjike në Shqipëri, duke u ndalur me detaje të Dea e Butrintit. "Si u pa e lulezuar në kohërat greke e romake. Shqipëria, që deri dje shfaqej disi barbare, po na sjell që prej disa kohësh, falë dy misioneve franceze e italiane, prova të një qytetërimi të epërm, që ky vend kishte arritur gjatë lashtësisë. Zbulimi më i rëndësishëm i bërë në Butrintin apo Butrinto, duhet të na ndalë disa çaste".

Teksa misioni francez, i drejtuar nga Z. Léon Rey po eksploron me sukses Apoloninë, e cila na ka dhënë kohët e fundit një pasqyrë të bukur greke dhe shumë statuja mermeri, zbulurime të një godine të madhe që ende nuk është spastruar plotësisht, misioni italian i drejtuar nga zoti Luigi Ugolini e ka përqendruar veprimtarinë e vet kryesore në Feniki (Finiq)



dhe në Butrint. "Ja si shkruan ndër të tjera profesor Neritan Ceka për arkeologun italian, që herë vlerësohet dhe herë puna e tij merret me dyshime. "Ugolini pati shkelur për herë të parë në Butrintin gjatë udhëtimit të tij për një ditë në vitin 1924. Siç e përshkruan në librin e vet të parë, ai arriti atje një mbrëmje, duke u ngjitur përjetë Vivarit me një barkë dhe i pa rrënojat e qytetit të lashtë vetëm duke e qarkuar që nga buza e ujit dhe nga bregu përballë". "Për më tepër ishte mbrëmje, - shkruan Ugolini, - megjithatë shikojta rrënojat e mureve të kësh-tjellës veneciane dhe turke të veshura në mënyrë poetike me kulpra dhe pranë bregut, mbetje mermeri dhe varre të veshura me pllaka. Kujtoj të kem parë mure të bukura rrethuese në pjesën e lartë të kodrës, ndërtuar me blloqe të rregullt kuadratikë. Në anën juglindore të mureve ka një portë të hyrjes për në qytet me thellësi rreth 8 metra dhe gjerësi rreth 2 metra. Besoj se nuk do të jetë e vështirë të identifikohen këto rrënoja me qytetin antik Buthrotum...". Ishte pothuaj një mirazh, që i shfaqej arkeologut 29-vjeçar me forcën e magjisë që pati tërhequr Schliemannin drejt Trojes apo Evansin drejt Knosit, e mbyll dedikimin e tij profesor Ceka i riu. Kjo është Dea dhe historia e saj. *

Prej pesë vitesh, falë një ideje të mençur dhe kurajoze të kineastit Edmond Topi mori udhë festivali ndërkombëtar i filmimit me titull "Dea Open Air International

Film Festival", që do të lexohej: "Festivali ndërkombëtar i filmimit 'Dea', në qiell të hapur". Jam dëshmitar okular i të gjitha edicioneve. Një punë serioze në selektimin e filmave konkurrues të të gjitha zhanreve, me metrazh të gjatë, të shkurtër dhe eksperimental. Juri serioze me përbërje tejet elitare të personaliteteve të huaja dhe vendëse. Një bashkëpunim model me Kosovën si me Ministrinë e Kulturës atje, po ashtu edhe me "RTV 21" si partner mediatiq. Filma të prodhimeve të viteve të fundit dhe që kanë pasur gjeografi territoriale ngjarësh dhe historish, ndodhish dhe përjetimesh në të gjithë Europën, përfshi Rusinë dhe Izraelin, si dhe gjeografi emocionale mjaft të goditur. Në respekt të Deas së imazhit kanë qenë prezentë krijuesit, si regjisorë, skenaristë, aktorë, producentë, njerëz të medias etj. Kjo prurje dhe prani sa njerëzore po aq edhe artistike është shpirti kulturor i festivalit. Shkolla të ndryshme të kinematografisë, modele që joshin me gjithçka realizojnë, eksperiencia pune, ide dhe debate rreth tyre, teknika xhirimi, kulturne dhe kamerës, montazhi dhe ritmi, financimet dhe sigurimi i buxheteve, loja aktoriale, koha e realizimit, puna në pasprodhim, vlerësimi i publikut, gjykimet e kritikës, pasqyrimet në media, ecuria e filmave nëpër festival, çmimet, pengjet e autorëve, sakrificat e tyre, pasionet e hapura dhe të fshehura, kënaqësitë dhimbjet dhe lotët.

Të gjitha bashkë në një javë festival në qytetin e Sarandës, së

paku në segmentin kohor 2013-2018. Dhe janë vetëm dy njerëz, kineasti Edi Topi dhe profesoresha e komunikimit, Mirela Oktrova Topi. Zoti Topi me pasionin dhe vrellin, zonja Topi me vetëpërm-bajtjen dhe qetësinë. Të dy bashkë me përkushtimin dhe kulturën tipike europiane enkas gjermanike e linden dhe e zhvilluan këtë festival. Po Dea e antikitetit si flet me gjuhën e imazhit? Kjo është bregu ime. Shfaqja e filmimit në kinema 'Limani' në mes të detit krijon emocione, por gjykoj se nëse festivali do të zhvillohej brenda në qytetin antik të Butrintit, gjithçka do ishte krejt ndryshe. Të gjithë ata që i bashkohen këtë festivali do të mësonin më shumë për Dean, Butrintin dhe për antikitetin e popullit tonë si dhe për kontributet, lidhjet dhe dhënie-marrjet në rrjedhat historike. Mbasa ndokush mund të xhironte një film me metrazh të gjatë për ikjen e Deas me trup dhe me kokë dhe kthimin e saj vetëm si kokë. Le të shpresojmë! Nga data 2 deri në 8 shtator 2018 në Sarandë në kinema 'Limani' u zhvillua festivali ndërkombëtar i filmimit me emrin e bukur Dea, edicioni i pestë. Vinte nata dhe në mes të detit ne mblidhemi shqiptar dhe të huaj, kineastë dhe të dashuruar pas magjisë së ekranit të madh, artistë karriere dhe të rinj me ëndrra për artin e imazhit. Nata e parë hapëse na rezervoi një befasi.

Jashtë konkurrimit pamë film-in e ri shqiptar "Yjet e së ardhmes", një krijim i Edmond Topit. Me lojën e Tinka Kurtit, Margarita Xhepës dhe Reshat Ar-

banës dhe me një grup aktorësh të rinj, brenda një metafore shumë të bukur, zbulohet rigjetja e ëndrrës së ndaluar dhe realizimi i saj si një sfidë edhe ndaj kotësisë së ditëve tona, përballë një brezi të ri që nuk di si të sillet me lirinë e vet. Natën e dytë festivali u hap me një film gjerman konkurrues, titulluar "Temperament" prodhim i vitit 2018, i regjisorit Steffen Hacker, i pranishëm në festival bashkë me aktoren protagoniste. Filmi evokonte përmes kujtimeve dhe përjetimeve dy kohë. Jeta e dy vazhava të vogla që rriten në jetimore dhe deformimet mendore e shpirtërore për shkak të keqtrajtimit dhe i ndjekin ato në jetë kur janë rritur. Udhëtohet në tri dimensione, atë real, atë kujtimor dhe atë imagjnativ. Me një motivim të brendshëm sipas motos "beso te vetja dhe mos u dorëzo", ngjarjet e filmimit vrapojnë. Dyzimi njerëzor jepet herë si dobësi, herë si gjetje e fuqisë. Dinjiteti njerëzor është penduli i historisë së individit. Po që se sëmurët dinjiteti apo ai nëpërkëmbet, jeta juaj është një luftë për rikthimin e tij. Loja e aktore kryesore ishte tejet impresionuese. Dyzimi si luftë brenda vetes për të mos braktisur dinjitetin dhe rreziku që vjen nga trajtimi që mund të të bëjnë, duke të trajtuar si një objekt i detyruar që ta gjejë sjelljen e vet te kurimi dhe tek urdhri institucional. Gjithçka shpërfaqej me skena tejet dramatike. Kamera dhe efektet gjithashtu tronditnin. Mbase personalisht më la përshtypje dimensionimi me kahe nga thellësitë e nënvetëdijes njerëzore deri në kupën qiellore të katedrales. Dheala reale nuk është asgje përpara asaj të fshehurës që e shtrembëron udhën e jetës, duke e shfrytëzuar pafuqinë fëmijërore të jetimëve. Sa orfany ka sot në botë dhe ku e shpje ajo njerëzimin e nesërm? Kjo ishte pyetja që iu drejtova pas shfaqjes regjisorit dhe aktore. E nëse shton edhe dhunimin dhe depersonalizimin, kriza e identitetit thellohet edhe më. Natën e dytë të konkurrimit u shfaq një film spanjoll me titull "Deti i zbrazët dhe shterp".

Një ngjarje e thjeshtë në pamje, madje e kursyer si ambiente, si hapsëirë dhe si realitet. Një fshat i izoluar, ku një djali i ri ishte boshti i jetës. Rreth tij lëvizin ngjarjet, fatet, ëndrrat, imagjinata dhe pasionet e verbëta. Gjyshi që e ka orientimin ende në të shkuarën, e cila i ka mbetur peng. Nipi i lexonte historinë e Spanjës, që për plakun kishte mbetur të koha e diktatorit Franko. I pëlqente të dëgjonte se si mashtërimi mbi mrekullinë e regjimit përfundoi për fshatarët me humbjen e tokës. Ishte prezente nëna e djaloshtit, që me kujdesin e tij mbante kafenenë e fshatit. Ishte e dashura që thurte ëndrra për një botë ndryshe dhe për ikjen një ditë prej andej. Ishte edhe kushërija e tij që mbaronte të bënte seks me të. Filmi nis me → momentin që djali ishte

Kupa e Shqipërisë

Superliga nuk zhgënjën, Vllaznia ngec në Burrel

Kupa e Shqipërisë nuk ka dhuruar surpriza në ndeshjet e saj të para, teksa të gjitha skuadrat e Kategorisë Superiore kanë fituar përballjet e tyre në transfertë, duke siguruar praktikisht kualifikimin që në 90 minutat e para. Skënderbeu dhe Luftëtari kanë fituar me goleadë në transfertë përballë Veleçikut dhe Vorës, ndërkohë që Partizanin i ka mjaftuar goli i Çinarit përballë Tërbunit të Kategorisë së Dytë. Klodian Duro ka debutuar me fitore në stolin e Kamzës, teksa ka mposhtur Besën me rezul-

KUPA E SHQIPËRISË

Grupi A		Grupi B	
Veleçiku-Skënderbeu	0-3	Oriku - Kukësi	1-2
Vora - Luftëtari	0-4	Naftëtari - Laçi	0-5
Tërbuni - Partizani	0-1	Shkumbini-Flamurtari	0-1
Besa - Kamza	0-2	Turbina - Teuta	0-3
Burreli - Vllaznia	1-1	Shënkollin - Lushnja	1-2
Korabi - Kastrioti	1-1	Iliria - Tirana	1-4
Dinamo - Egnatia	0-1	Tomori - Bylis	2-1
Besëlidhja - Erzeni	1-0	Pogradeci - Apolonia	0-1

tatin 0-2. Dopieta e Teqjes i dha fitoren skuadrës kryeqytetas. Kastrioti është i vetmi ekip nga Superiorja, që nuk ka triumfuar në Grupin A. Skuadra krutane barazoi me rezultatin 1-1 në transfertë përballë Korabit, teksa kualifikimi do të vendoset në ndeshjen e kthimit. Në grupin B, Laçi finalist i Kupës së Shqipërisë vjet, nuk ka falur Naftëtarin, teksa ka shënuar pesë herë në portën e kuçovarëve. Kukësi i është falur Ethemit në



transfertën me Orikun. Teuta në Cërrik ka bërë detyrën, duke fituar me tre gola. Fitore e Flamurtarit në fund, kurse Tirana ka përmbytur Lushnja ka përmbytur Shënkollin, duke fituar 1-2. Tomori ia ka dalë me sukses ndaj Bylisit, sikurse Apolonia me Pogradecin në transfertë.

Tirana kërkon fitoren e parë të dielën, Laçi dhe Partizani përplasën "brirët" mes tyre

E katërta e Superiores, pritshmëri dhe pikëpyetje

Në Vlorë luhet kryendeshja Flamurtari-Skënderbeu

Jeton Selimi

Kategoria Superiore do të rikthehet këtë fundjavë me javën e katërt të saj, ndërsa pas 270 minutash të luajtura, padyshim që pikëpyetjet për disa skuadra janë të shumta, ashtu sikundër edhe dëshira për konfirmim në pjesën e sipërme të tabelës. Dhe natyrisht që sytë janë drejtuar në Vlorë, ku të hënën do të luhet kryendeshja Flamurtari-Skënderbeu. Kampionët udhëtojnë në fushën e skuadrës së ndërtuar pikërisht për shkurrëzimin e korçarëve, teksa në stolin kuqezi është ulur arkitekti i titullit të fundit bardhekuq, Ilir Daja. Natyrisht, që në letër është e vështirë të përcaktosh fituesin, ndonëse Skënderbeu vjen si fitues në fuqi. Gjithsesi, lajmi më i rëndësishëm nga Vlorë ka të bëjë me terrenin. Fusha në stadiumin "Flamurtari" paraqitet në gjendje optimale dhe kjo i gëzon padyshim të dyja skuadrat, që do të luajnë të hënën në orën 19:45.



boshllëk aq shumë të debatuar nga trajneri brazilian. Nga ana tjetër, Luftëtari i slovenit Kostić, një Luftëtar që nuk ka marrë ende asnjë pikë dhe që është larg ekipit spektakolar që kemi shijuar në dy edicionet e fundit.

Në Laç krubinasit presin Partizanin, dy skuadra në ndjekje të kretit. Laçianët janë gati për të luftuar për titullin, referuar deklaratës së presidentit Laska, ndërsa të kuqtë ende nuk janë një ekip për titull, sikundër ka përsëritur shpesh trajneri Gega, por gjithsesi të dyja skuadrat janë aty, të gatshme për të përfituar nga sfida e Vlorës.

Teuta e Bledi Shkëmbit është ekipi që ka argëtuar më shumë në këtë start sezoni. Bregdetarët kanë shënuar një gol të vetëm, por janë gjithnjë prezentë te zona kundërshtarë. Ndaj Kukësi është i paralajmëruar, ndonëse fitorja me Tiranën ka kthyer qetësinë te

nënkampionët. Gjithsesi, Cungu ka jo pak dhimbje koke për këtë 90-minutësh, pasi nuk do të ketë në dispozicion Rexhinaldon, që u dëmtua në grumbullim në këtë faqësuesen e Mozambikut. Në fund është Kamza-Kastrioti. Të dyja skuadrat kanë nga 3 pikë të arkëtuara në javën e

parë, më pas nga dy humbje, që të Kamza sollën shkarkimin e Bledar Devollit dhe emërimin e Klodian Duros, i cili do të debutojë kundër Elvis Plorit në këtë edicion. Si Kamza, ashtu edhe Kastrioti duan pikë në këtë përballje, ndërsa Duro ëndërron startin perfekt.

SUPERLIGA

Java e 4-të

Të shtunën

Kamza - Kastrioti	15:45
Teuta - Kukësi	18:45
Të dielën	
Laçi - Partizani	15:45
Tirana - Luftëtari	18:45
Të hënën	
Flamurtari-Skënderbeu	19:45

RENDITJA

Skuadra	N	P
Skënderbeu	3	7
Flamurtari	3	7
Partizani	3	6
Laçi	3	5
Teuta	3	5
Kukësi	3	4
Kamza	3	3
Kastrioti	3	3
Tirana	3	1
Luftëtari	3	0

TALENTI

Asensio "siluron" Ronaldon: Me ose pa të kërkoj një rol të rëndësishëm te Real

Marko Asensio është shndërruar në një yll në kryeqytetin spanjoll, me skuadrën e Real Madrid, por edhe me kombëtaren e "La Roja". Spanjollin ka fituar dy tituj të Ligës së Kampionëve nën drejtimin e Zidaneit, një kampionat La Liga dhe një Superkupë Spanje. Edhe pse shumë i suksesshëm, 22-vjeçari nuk ka qenë asnjëherë zgjedhje e parë në Madrid. Kjo po fillon të ndryshojë tani që Kristiano Ronaldo ka lëvizur dhe ai ka luajtur pothuajse çdo minutë në tri ndeshjet që Real ka luajtur deri më tani dhe po shndërrohet në titullar edhe në Kombëtaren e Spanjës. Duke folur për spanjollin "Panenka", ai zbuloi se ka ambicie në nivel kombëtar dhe klub, duke filluar me ndryshimin e numrit të tij nga 20, duke thënë: "Unë nuk dua t'i jap fund karrierës sime ende të veshur me fanellën e numër 20. Mendoj se kjo shpjegon gjithçka rreth asaj se si ndihem. A do të dëshiroja ta ndryshoja atë? Sigurisht, do të shohim se çfarë ndodh". Ai shpjegoi se jeta pa Kristiano Ronaldon gjithashtu shton ambicion, duke shtuar: "Me ose pa Kristiano, unë po i afrohem sezonit të ri plot shpresë, me qëllim të mbajtjes së një vendi të rregullt në formacion dhe duke luajtur një rol më të rëndësishëm. Kjo duket të ndodhë, pasi unë kam filluar sezonin mirë dhe jam duke punuar mirë". Me Ronaldon të larguar tashmë, Asensio duket gati për të shpërthyer me Real Madridin dhe për të qenë ai numri 1 dhe lideri i "Los Blancos".

SULMUESI I INTERIT




Keita Balde: Dua të shënoj 20 gola në këtë sezon

Sulmuesi i Interit, Keita Balde, foli për "SkySports", duke kujtuar golin e tij të parë kundër Parmës. Zikaltrit do të përballen me Parmën në fundjavën e ardhshme, në një ndeshje që sjell kujtime të bukura për Keita Balde, pasi ai shënoi golin e tij të parë kundër kësaj skuadre, kur luante për Lacion: "Ne luajtëm në stadiumin e tyre, një ndeshje shumë e vështirë, sidomos për sulmuesit, pasi ata mbrohën mirë.

Por arrita të shënoj golin e parë në Itali dhe është një moment i paharrueshëm. A jam unë një sulmues që shënon 15-20 gola? Mendoj se po, kam cilësitë për ta bërë këtë, sidomos tek Interi, pasi kjo skuadër është e përbërë nga djem të shkëlqyeshëm. Ne jemi një ekip i fortë, plot me lojtarë të rinj, të cilët duhet të integrohen dhe të njohin njëri-tjetrin, por ne jemi të fortë", - tha Keita për "SkySports".

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- U shkrua nga Zweig.
- Fillojnë aksionin.
- Janë për t'u krenrtuar.
- Sejdimi i trinarëve.
- Ai i Don Kishotit ishte Sanço Pança.
- Ekstremitë në tunel.
- I ka tek vrap.
- Fillojnë andej.
- Nuk tregohet nga i pasigurti.
- Luftojnë me pagesë.
- Initiallet e Gere aktor.
- Sirena që i dha emrin Napolit.
- Giymë fejeshe.
- E ka simbolin Co një i tillë.
- Initiallet e Kazan, regjisor.
- Turner aktore.
- Në radhë të parë.
- As unë as ti.
- Janë galeri në rrugë.
- Gibson aktor.

VERTIKAL

- Eshtë edhe ajo epizootike.
- Një është edhe Korabi.
- I këni në dorë.
- Eshtë mbulesë mbi... hambar.
- Kufijtë e kujtesës.
- Janë tek në faqe.
- Kështu përfundon Loreley.
- Një vend niseje.
- Në këtë moment.
- Në krye të artistëve.
- Robbins aktor.
- Ai i Hekurt ishte Bismarck.
- Qërohen me... llogari.
- U shkrua nga Kundera.
- Eshtë dhuna me fjalë.
- Yoko e John Lennon.
- Një vepër... taumaturgu.
- Ente Ekonomike Autonome.
- Një mund të jetë cirku.
- Janë indigjenë neozelandezë.
- Eshtë edhe ajo gjeografike.
- Initiallet e Klep piktor.
- Ishin formacionet e famshme maqedonase.
- Eshtë e zakonshme për pushtime.
- Emil piktor.
- Një planet i Kuq.
- Një garë në hipodrom.
- Me të nxjerrin një litër.
- Qorre pa qe.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL

- Eshtë trofe sportiv.
- U hahen... të martuarve.
- Kufizojnë një truk.
- Kërcimi i Zorba Grekut.
- Mund të jenë kohore.
- Kardashian, aktore dhe modele.
- Janë përmasa.
- Eshtë pjesë e gjuhës.
- Nafta e Shell.
- Një i dhjetë në vit.
- Letra pa zë.
- Janë qederet, dëmet.
- Ishin kundërshtarë të babilonase.
- Eshtë llon papagalili.
- Tregon çmimin me... mirësjellje.
- Fillojnë ndeshjet.
- Të parat në stadium.

VERTIKAL

- Në krye të kryesisë.
- Eshtë shfaqje e parë.
- Ross këngëtare.
- Kërkojnë talent të tilla.
- Të parat në stadium.
- Një pjesë e makinacioneve.
- Vrau Hektorin.
- Roth aktor.
- Qe piktor i famshëm italian.
- Janë vjedhës.
- Kompozitori i Sinfonia e dymbëdhjetë.
- Një çiklist në velodrom.
- Eshtë e ardhur nga firma piramidale.
- Pak diktaturë.
- Një mund të jetë me... ku-ku.
- Nota e diapazonit.
- Masin lëngje të tilla.
- Janë forma.
- I vidthe ustatit.
- Eshtë pjesë telefilm.
- Pikas pa ekstreme.
- Eshtë ambëlisirë me qiri.
- Umberto poet italian.
- Dy asa.
- Kollet por jo kot.
- Radiotelevizioni i Kosovës.
- Initiallet e Delon.
- Fillojnë afërsisht.



Gjeni ndryshimin

Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra

Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOK

			9	3		1	4
9	4						
5	3	7					9
4		8				5	
	7			2		6	1
8			6	9			2
1							
	6	5	2				
			7		6		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	7	2	5	8	3	6	9	4
4	8	3	9	6	2	1	7	5
5	6	9	4	7	1	8	2	3
2	3	8	1	4	6	7	5	9
6	1	7	3	5	9	2	4	8
9	4	5	7	2	8	3	1	6
3	2	1	6	9	5	4	8	7
7	9	6	8	1	4	5	3	2
8	5	4	2	3	7	9	6	1

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

T	A	P	E	T	T	A	R	I	A	N	E
A	R	R	A	T	E	T	O	R	R	E	S
R	T	M	A	R	S	D	E	R	C		
T	G	J	U	R	M	I	M	E	T	V	A
A	N	A	R	T	E	M	I	O	D	O	M
N	O	M	T	A	T	I	M	G	Z	I	
T	I	P	A	R	E	T	A	R	T	E	L
B	E	H	I	J	E	E	L	F	E	T	L
U	R	A	T	A	T	E	T	E	T	O	
K	E	L	T	E	B	I	A	A	R	A	M
A	T	T	E	R	A	P	I	S	A	M	
F	R	E	N	I	A	R	M	A	N	I	
B	A	L	E	T	H	P	A	S	T	O	R
U	R	I	A	A	T	A	D	E	R	E	K
S	T	A	M	P	E	N	H	R	I	N	I
T	E	N	A	M	A	D	E	U	S	E	P
E	R	E	R	E	M	E	T	I	N	A	P
R	I	K	A	T	R	O	R	B	E	L	A
K	A	N	D	I	N	I	R	R	A	N	I
E	A	M	O	S	I	M	A	S	K	A	
A	N	T	I	K	E	T	B	M	O	R	
T	O	R	A	S	M	O	D	E	N	O	T
O	R	L	E	A	P	S	L	A	R	A	
N	A	N	A	N	I	V	E	A	L	I	S

Argëtim filozofik

- Disa njerëz shfryjnë sepse trëndafilat kanë gjemba. Unë jam mirënjohës që gjembat kanë trëndafila.
- Të ecësh me një mik në errësirë, është më mirë se sa të ecësh i vetëm në dritë.
- Fëmijët janë kureshtarë. Fëmijët vëzhgojnë mlingonat ndërsa të rriturit i shkelin.
- Nëse gjithmonë bën atë që të pëlqen, të paktën një person është i kënaqur.

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

T	5	4	11	4	1	19	3	13	4	16	E	K	S	P	E	R	I	M	E	N	T	F	
12	H	5	6	3	10	9	3	11	4	13	6	L	U	G	F	O	R	C	A	E	P	L	
1	E	13	7	11	4	19	4	7	2	2	1	I	T	R	A	S	I	A					
16	S	11	1	5	4	14	15	6	5	3	4	A	F	A	R	M	A	C	I	S	T	E	
7	1	5	1	14	18	1	12	3	2	2	1	F	A	C	S	I	M	I	L	E	R		
15	1	7	1	13	7	3	19	3	1	13	16	M	A	R	I	A	N	A	P	I	N	E	D
4	14	1	17	4	14	9	4	7	3	4	1	I	R	I	S	G	R	A	S	O	T		
9	6	5	5	3	11	3	9	19	9	19		K	A	S	T	A	P	O	E	T			
4	5	5	3	1	4	12	3	5	5	5		D	E	E	P	E	T	O	R	T	A		
5	1	4	2	16	1	2	2	1	5	16		U	J	T	G	T	M	R	E	A	L		
1	18	1	5	4	9	4	14	1	7	3		F	A	T	U	J	E	S	E	D	R	A	
7	5	4	13	7	3	4	1	10	3	2		O	D	E	K	U	R	I	M	I	A	N	

Thënie të mënçura

- Shtëpinë e njeriut të punësuar, uria e shikon nga jashtë, dhe nuk guxon të hyjë brenda.
- Çdo njeri është i dhënë pas një diçkaje dhe sa më e rëndësishme të jetë ajo "diçka" sa më e madhe, aq më e çmuar është jeta e njeriut.
- Askush s'mund të lavdërohet se do të mund të jetonte edhe pa njerëz.
- Kush nuk di të bekojë, duhet të mësojë të mallkojë.

